




Platforma Regjionale e Ballkanit Perëndimor për Avokim të  
Lirisë së Medie dhe Sigurisë së Gazetarëve  
Western Balkan's Regional Platform for Advocating  
Media Freedom and Journalists' Safety

# **KOSOVA**

## **Treguesit e nivelit të lirisë së medie dhe sigurisë së gazetarëve 2019**





**KOSOVA  
Treguesit  
e nivelit të  
lirisë së  
medieeve dhe  
sigurisë së  
gazetarëve  
2019**

**Autor:  
Liron Kafexholli**

### Titulli original

Kosova - Treguesit e nivelit të sigurisë së medieeve dhe sigurisë së gazetarëve 2019

### Botuesi

Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës



Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës  
Association of Journalists of Kosovo

### Autor

Liron Kafexholli

### Lektor

Arsim Halili

### Tirazhi

50

### Dizajni

comma | communications design

Ky publikim është prodhuar me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian dhe Fondit Evropian për Demokraci. Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi e vetme e Asociacionit të Gazetarëve të Kosovës dhe nuk reflekton pikëpamjet e Bashkimit Evropian dhe të Fondit Evropian për Demokraci.



EUROPEAN  
ENDOWMENT FOR DEMOCRACY

<b>PËRMBLEDHJE E PROJEKTIT</b>	<b>4</b>	<b>C Siguria e gazetarëve</b>	<b>22</b>
<b>METODOLOGJIA</b>	<b>5</b>	C1 Sjellja e institucioneve shtetërore dhe e aktorëve politikë në lidhje me mbrojtjen e gazetarëve	25
<b>Hyrje</b>	<b>7</b>	C2 Qasja e kodit penal dhe civil të drejtësisë ndaj kërcënimeve dhe akteve të dhunës ndaj gazetarëve	25
<b>A Mbrojtja Ligjore</b>	<b>9</b>	<b>Analiza dhe konkluzione</b>	<b>27</b>
A1 Garancitë ligjore të lirisë së medias dhe zbatimi i tyre në praktikë	9	A Mbrojtja ligjore	27
A2 Efektet e ligjeve kundër shpifjes te gazetarët	11	B Pozita e gazetarëve në redaksi	28
A3 Mbrojtja ligjore dhe pluralizmi politik në media	12	C Siguria e gazetarëve	29
A4 Liria në punë, garancitë dhe praktikat e asociacioneve	13	Rekomandimet	30
A5 Mbrojtja ligjore e burimeve të gazetarëve	14		
A6 Mbrojtja e së drejtës për qasje në informata	14		
<b>B Pozita e gazetarëve në redaksi, etika profesionale dhe niveli i censurës</b>	<b>16</b>		
B1 A është abuzuar me pozitën ekonomike të gazetarëve për të kufizuar lirinë e tyre?	16		
B2 Cili është niveli i pavarësisë editoriale nga pronarët e medieve dhe nga organet drejtuese?	17		
B3 Pavarësia editoriale në Transmetuesin Publik	18		
B4 Pavarësia editoriale në mediet e sektorit jofitimprurës	20		
B5 Liria e gazetarëve në procesin e prodhimit të lajmeve	20		
B6 Pozita e gazetarëve	21		

# PËRMBLEDHJE E PROJEKTIT

Në vitin 2016, asociacionet e gazetarëve të pesë vendeve të Ballkanit Perëndimor (Bosnjë e Hercegovinë, Maqedoni e Veriut, Mal i Zi, Kosovë dhe Serbi), me mbështetjen e Komisionit Evropian<sup>1</sup>, i bashkuan përpjekjet për monitorimin dhe avancimin e nivelit të lirisë së medie-ve dhe të sigurisë së gazetarëve, duke e krijuar Platformën Rajonale të Ballkanit Perëndimor për Mbrojtjen e Lirisë së Medias dhe Sigurinë e Gazetarëve. Në bazë të një metodologjie të përbashkët kërkimore, të zhvilluar për këtë qëllim, këto organizata, çdo vit, mbledhin të dhëna, vlerësojnë zhvillimet më të reja dhe përfshihen në aktivitete avokimi për t'i ndryshuar mjediset politike, legjislative dhe institucionale, në të cilat punojnë gazetarët dhe funksionojnë mediet.

Rezultatet që janë arritur në ciklin e parë trevjeçar, treguan se asociacionet e gazetarëve në rajon mund të luajnë rol vendimtar në përpjekjet e tyre për avancimin e lirisë së medie-ve. Kjo arritje është vlerësuar nga Komisioni Evropian (KE) si një hap themelor drejt demokratizimit të përgjithshëm të shoqërive në Ballkan, që ndikoi në vendimin e këtij institucioni për ta vazhduar mbështetjen për Platformën rajonale edhe në vitet vijuese<sup>2</sup>. Ky raport narrativ është përgatitur në vitin 2019, në kuadër të kornizës së vlerësimit të katërt të nivelit të lirisë së medie-ve dhe të sigurisë së gazetarëve në Ballkanin Perëndimor<sup>3</sup>.

- 
- <sup>1</sup> Platforma rajonale e Ballkanit Perëndimor për mbrojtjen e lirisë së mediave dhe sigurinë e gazetarëve është projekt i financuar nga Komisioni Evropian, në kuadër të Programit për aftësimin e shoqërisë civile dhe medias 2014-2015, Mbështetje për rrjetet rajonale tematike të Organizatave të Shoqërisë Civile.
  - <sup>2</sup> Komisioni Evropian miratoi projektin e ri trevjeçar "Safejournalists.net" me kontratë të grantit nga IPA/2019/414-122
  - <sup>3</sup> Vlerësimi i nivelit të lirisë së mediave dhe sigurisë së gazetarëve në Ballkanin Perëndimor në vitin 2019 u mbështet financiarisht nga Fondacioni Evropian për Demokraci.

# METODOLOGJIA

Metodologjia e kërkimit<sup>4</sup> përbëhet nga tri grupe treguesish, të strukturuar sipas një analize sistematike të udhëzimeve që janë hartuar nga organizatat ndërkombëtare përkatëse<sup>5</sup>. Gjatë katër viteve të kaluara, këta tregues janë testuar dhe përpunuar, që të adresojnë kontekstin e veçantë socio-politik në rajon dhe t'i pasqyrojnë nevojat dhe interesat specifike të gazetarëve në këto pesë vende.

Për t'i mbledhur dhe analizuar të dhënat janë përdorur një varg metodash kërkimore:

- Shqyrtimi i studimeve, analizave, raporteve hulumtuese, programeve politike, strategjive dhe dokumenteve tjera;
- Analizimi cilësor i dispozitave ligjore;
- Mbledhja dhe analizimi i informatave të publikuara në faqet e internetit të institucioneve publike, dhe të organizatave tjera;
- Mbledhja dhe analizimi i komunikatave për shtyp, njoftimeve dhe informatave të përgatitura nga organizatat profesionale;
- Të dhënat dytësore që mblidhen nga asociacionet e gazetarëve;
- Intervistat gjithëpërfshirëse me ekspertë, asociacionet e gazetarëve dhe politikbërës;
- Fokus-grupet me gazetarë.

Asociacionet e gazetarëve emëruan hulumtues vendorë për mbledhjen e të dhënave dhe për hartimin e raporteve narrative, të cilat më pas u rishikuan nga dy vlerësues të vendit dhe nga hulumtuesi kryesor.

Tri grupet e treguesve, që u përdorën për vlerësimin e nivelit të lirisë së medieeve dhe të sigurisë së gazetarëve në Ballkanin Perëndimor, janë paraqitur në tabelën e mëposhtme.

Tabela e treguesve:

A. Mbrojtja ligjore	B. Pozita e gazetarëve në redaksi	C. Siguria e gazetarëve
A.1 Garancitë ligjore për lirinë e medieeve dhe zbatimin e tyre në praktikë	B.1 Kufizimet ekonomike në punën e gazetarëve	C.1 Statistikat për sulmet ndaj gazetarëve dhe pandëshkueshmëria
B.1 Kufizimet ekonomike në punën e gazetarëve	B.2 Pavarësia nga pronarët e medieeve dhe nga menaxherët	C.2 Sjellja e institucioneve dhe akterëve politikë lidhur me mbrojtjen e gazetarëve
A.2 Efekti i ligjeve për shpifje ndaj gazetarëve	B.3 Pavarësia e gazetarëve në Transmetuesin publik	C.3 Efikasiteti i sistemit gjyqësor në lidhje me mbrojtjen e gazetarëve
B.2 Pavarësia nga pronarët e medieeve dhe nga menaxherët	B.4 Pavarësia e gazetarëve në sektorin jofitimprurës	
A.3 Mbrojtja e pluralizmit politik në media	B.5 Pavarësia e gazetarëve në procesin e prodhimit të lajmeve	
B.3 Pavarësia e gazetarëve në Transmetuesin publik	B.6 Pozita e grave në gazetari	

4 Edicioni i katërt i përshtatur i metodologjisë kërkimore u zhvillua nga hulumtuesja kryesore Snezana Trpevska dhe nga Igor Micevski, bashkëpunëtor kërkimor në Institutin për Kërkime të Zhvillime Sociale, RESIS nga Shkupi, Maqedoni e Veriut.

5 Gjatë zhvillimit të qasjes kërkimore specifike për vendet e Ballkanit Perëndimor janë marrë parasysh dokumentet në vijim: Këshilli i Evropës: Treguesit për Median në Demokraci; UNESCO: Treguesit e Zhvillimit të Medias (MDI) dhe Treguesit për Sigurinë e Gazetarëve: Niveli Kombëtar; USAID – IREX: Indeksi i Qëndrueshmërisë së Medias; Freedom House: Hulumtimi i Lirisë së Shtypit; Shërbimi botëror i BBC-së: Iniciativa për Zhvillimin e Medias në Afrikë; Komiteti për Mbrojtjen e Gazetarëve: Dhuna ndaj gazetarëve; Reporterët pa Kufij: Treguesi Botëror i Lirisë së Shtypit.





Kosova është republikë parlamentare unitare, me qeveri, kuvend njëdhomësh dhe sistem juridik civil. Kosova funksionon si shtet i pavarur dhe trajtohet si i tillë nga një numër i madh i shteteve, ndonëse shtetësia e saj kontestohet nga një numër i vogël i vendeve anëtare të Organizatës së Kombeve të Bashkuara (OKB). Kosova ka strukturë demografike shumë-etnike. Shqiptarët e përbëjnë shumicën dërmuese të popullsisë, kurse komunitetet tjera etnike: serbët, boshnjakët, turqit, romët, goranët e të tjerët, përbëjnë pjesën tjetër.

Konteksti politik në Kosovë është shoqëruar me sfida. Dorëheqja e kryeministrit, në korrik të vitit 2019<sup>1</sup>, e çoi vendin në zgjedhje të parakohshme parlamentare në tetor 2019, që shkaktoi bllokadë politike, ku qeveria deri në fund të 2019, ende nuk është formuar<sup>2</sup>. Kosova vazhdon të përballlet me nivele të larta të varfërisë dhe të papunësisë.<sup>3</sup> Tregu i punës mbetet sfidë për zhvillimin ekonomik të Kosovës, ndonëse ka zhvillim të ngadalshëm ekonomik dhe rritje të vogël të eksporteve, përqendruar kryesisht në eksportet e shërbimeve. Në sektorë të caktuar ka mungesë të madhe të punëtorëve të aftësuar për punë, problem që nuk po adresohet nga sistemi arsimor, i cili nuk ka mbështetje të mjaftueshme për zhvillim. Ambienti politik, shoqëror dhe ekonomik karakterizohet me shkallë të lartë të nepotizmit dhe klientelizmit. Ka dëshmi ed-

- 
- 1 Radio Evropa e Lirë /Radio Liberty Balkan Service (RFE/RL). Kryeministri i Kosovës jep dorëheqje, me arsyetim se nga Dhoma e Prokurorisë së Specializuar në Hagë është ftuar si "i dyshuar". 19 korrik 2019. <https://www.rferl.org/a/Kosovo-s-prime-minister-resigns/30065153.html>
  - 2 Bami, Xhorxhina. Bisedimet e koalicionit mbeten të bllokuara në Kosovë. BIRN. Prishtinë. 26 dhjetor 2019. <https://balkaninsight.com/2019/12/26/Kosovo-main-parties-fail-to-form-governing-coalition/>
  - 3 "Banka Botërore Kosovë Konteksti i vendit" Banka Botërore, Rifreskuar më: 26 tetor 2019 <https://www.worldbank.org/en/country/Kosovo/overview>

he për raste të shumta të korrupsionit, të cilat trajtohen shumë ngadalë nga organet e drejtësisë.<sup>4</sup>

Shkalla e lartë e varfërisë dhe e papunësisë dhe niveli i lartë i ekonomisë joformale, bëjnë që shumë punëtorë, përfshirë gazetarët, të pranojnë të punojnë në kushte të pafavorshme, pa kontrata, pa sigurime sociale dhe me status të paqendrueshëm. Sipas raportit të Bashkimit Evropian, kjo i bën gazetarët të ndjeshëm ndaj korrupsionit, prirjes për vetcensurim<sup>5</sup>, ndaj presioneve politike dhe të menaxherëve, gjë që mund të ndikoj në cilësinë dhe në profesionalizmin e tyre. Sipas po të njëjtit raport, konteksti politik ka pasur ndikime edhe më të mëdha te gazetarët e pakicës serbe, të cilët përballen me presione dhe me nivele të larta të vetcensurës.<sup>6</sup>

Kosova e ka një sistem medial pluralist, por të polarizuar, me një transmetues fragjil publik (TP), i cili është i ndjeshëm ndaj politizimit, për shkak të varëtisë financiare nga shteti dhe nga bordi drejtues që emërohet në baza politike, nga partitë në pushtet që përbëjnë shumicën në parlament. Nga viti 2018<sup>7</sup> në Kosovë ekzistojnë 20 stacione televizive (3 prej të cilave e kanë statusin e televizioneve nacionale), 83 radiostacione (39 operatorë kablovikë (1 OTT dhe 4 IPTV) dhe 61 ofrues të shërbimeve audio-vizuale që funksionojnë përmes shërbimit kabllor, si edhe 5 gazeta të përditshme<sup>8</sup>. Pesë prej stacioneve televizive në Kosovë transmetojnë program në gjuhën serbe, kurse një në gjuhën turke. Financimi i tyre varet kryesisht nga reklamat, pasi investimet vendëse ose të huaja në medie janë shumë të vogla. Nuk ekziston një statistikë e saktë e numrit të medieve online që veprojnë në Kosovë, pasi janë të regjistruara si shoqëri me përgjegjësi të kufizuara ose me pronësi të paverifikuara<sup>9</sup>. Kjo ka ngritur edhe më shumë shqetësimet për cilësinë e informacionit teksa shumë prej tyre janë akuzuar për komprometim të pavarësisë dhe etikës profesionale, për

shkak të përhapjes së gjuhës së urrejtjes, paragjyqimeve dhe të dezinformatave.<sup>10</sup>

Media më e preferuar në Kosovë, aktualisht është televizioni, ndonëse vitet e fundit është vërejtur një rritje e interesimit për mediet online ndërsa një rënie e interesimit për mediet e shtypura, për të cilat nuk ka të dhëna të pavarura për numrin e kopjeve të shitura. Mediet online kanë mesatarisht prej 200,000 (200 mijë) deri në 800,000 (800 mijë) klikime në ditë<sup>11</sup>. Sipas Indeksit të Qendrueshmërisë së Medieve (MSI) për vitin 2019, të hartuar nga Bordi Ndërkombëtar i Kërkimeve dhe Shkëmbimeve (IREX) rritja e interesimit për mediet online ka ndikuar negativisht në standardet etike të raportimit, pasi është rritur raportimi në kohë reale dhe vetëm një burim. Kjo vërteton se legjislacioni për lirinë e shprehjes dhe mbrojtjen sociale përkundër se është në përputhje me Bashkimin Evropian dhe standardet ndërkombëtare, lë shumë për të dëshiruar në zbatueshmëri.

4 Freedom House, <https://freedomhouse.org/country/kosovo/freedom-world/2020>

5 Bashkimi Evropian, Pakaia e zgjerimit e BE – liria e shprehjes – informata shoqëria dhe media 2019, Belgjikë, p.14-15, parë më 15 dhjetor 2019. [https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/freedom\\_of\\_expression\\_2019.pdf](https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/freedom_of_expression_2019.pdf)

6 Komisioni Evropian, Raporti për Kosovën 2019, Bruksel, p. 25, parë më: 18 tetor 2019; <https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/20190529-Kosovo-report.pdf>

7 Komisioni i Pavarur për Media (KPM), Raporti Vjetor 2017, Mars 2018, Prishtinë. P.28, <https://www.kpm-ks.org/assets/cms/uploads/files/Publikime/Dokumente/15459873378987.pdf>

8 BBC, "Profili i Kosovës – Media", BBC, 16 janar 2018, <https://www.bbc.com/news/world-europe-18328868>

9 "Udhëzuesi për gazetaret dhe mediet e lajmeve në Kosovë, ABYZ News Links", <http://www.abyznewslinks.com/kosov.htm>

10 Koha.net, "Lajmet e rrejshme dhe pronësia e portaleve në internet, sfidat për mediat online në Kosovë", Koha.net, 30 maj 2017. Parë më 5 janar 2020. <https://www.koha.net/arberi/21980/lajmet-e-rrejshme-dhe-pronesia-e-portaleve-sfide-per-mediat-online-ne-kosove/>

11 Naser Miftari, "E ardhmja e Transmetimit të Shërbimit Publik në Kosovë", Analitika, Dokument pune 3/2017, (2017): 34-37. [http://www.analitika.ba/sites/default/files/publikacije/psb\\_Kosovo.pdf?fbclid=IwAR2xKO8m2snPhqLxHjYDMsFNM7ZqhQqJ6d0HwBjG3pt5MHpETcpdUxGrLI](http://www.analitika.ba/sites/default/files/publikacije/psb_Kosovo.pdf?fbclid=IwAR2xKO8m2snPhqLxHjYDMsFNM7ZqhQqJ6d0HwBjG3pt5MHpETcpdUxGrLI)

## A1 Garancitë ligjore të lirisë së medias dhe zbatimi i tyre në praktikë

Liria e shprehjes dhe ajo e medieve janë të garantuara me Kushtetutë.<sup>12</sup> Këto garanci janë shtjelluar në disa ligje që rregullojnë aspekte të ndryshme të përmbajtjes së medieve, siç janë mbrojtja e privatësisë, ndalimi i gjuhës së urrejtjes, shpifjes dhe fyerjes si dhe e drejta e autorit.<sup>13</sup> Nuk ka ligj të veçantë që e rregullon qasjen në internet, por dispozitat e ligjeve tjera zbatohen edhe për publikimin e materialeve në internet. Mungon zbatimi efektiv i këtyre garancive, për disa arsye: burimet joadekuade dhe aftësitë e pamjaftueshme të institucioneve përkatëse, mungesa e vullnetit politik, zbatimi selektiv dhe procedurat e ngadalshme administrative, etj.<sup>14</sup> Në Raportin e Progresit për vitin 2019, Komisioni Evropian (KE) ka konstatuar se gjatë periudhës së raportimit, ka pasur një përparim të kufizuar në këtë fushë. Sipas KE-së, Transmetuesi Publik mbetet i ndjeshëm ndaj presionit

12 "Kushtetuta e Kosovës" [Constitution of the Republic of Kosovo], Article 40 (1). <http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Constitution%20Kosovo.pdf>

13 Ligji Nr. 04/L-046 për Radio Televizionin e Kosovës; Ligji Civil Nr. 02/L-65 kundër Shpifjes dhe Fyerjes; Ligji Nr. 04/L-44 për Komisionin e Pavarur të Mediave; Ligji Nr. 06/L-081 për Qasjen në Dokumente Publike; Ligji Nr. 04/L-137 për Mbrojtjen e Burimeve të Gazetarisë; Ligji Nr.06/L-085 për Mbrojtjen e Sinjalizuesve, etj.

14 Komisioni Evropian, Raporti për Kosovën 2019, Bruksel, p. 25, parë më: 18 tetor 2019: <https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/20190529-Kosovo-report.pdf>

dhe ndikimit politik dhe rekomandon që legjislacioni ekzistues për medie të rifreskohet dhe të zbatohet.<sup>15</sup>

Zhvillimi i Ligjit Nr. 06/L-081 për Qasjen në Dokumente Publike dhe puna për *rishikimin e Ligjit mbi transmetuesin publik* në vitin 2019 ishin pjesërisht transparente. Në seancat dëgjimore publike të organizuara nga Komisioni Parlamentar për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media, u përfshinë edhe OJQ-të, profesionistët e fushës dhe Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës (AGK), por periudha kohore ishte e shkurtër për të zhvilluar diskutime të përshtatshme, për të bërë analiza të thellura dhe paraqitur pikëpamjet e palëve të interesuara. Komisioni Evropian ngriti gjithashtu shqetësimin se në vitin 2019 nuk kishte nisma për rregullimin ligjor të pronësisë dhe transparencës së medieve.<sup>16</sup>

Nuk ka pasur përpjekje të autoriteteve shtetërore për të licencuar mediet e shtypit ose ato në internet, prandaj shumica janë të regjistruara si biznese ndërsa të tjerat si OJQ. Procedura e regjistrimit është e njëjtë si për çdo biznes tjetër dhe nuk kërkohen dokumente shtesë.

Nuk ka asnjë përpjekje të njohur/publike të autoriteteve shtetërore për kufizimin e së drejtës për të hyrë në internet ose për të provuar bllokimin e ndonjë mediumi online. Nuk është identifikuar ose nuk është raportuar as për ndonjë filtrim të përbajtjes.

Organi kryesor i pavarur rregullator i transmetimit audio-vizuel, Komisioni i Pavarur i Medieve (KPM), është duke i kryer në mënyrë të drejtë dhe neutrale detyrimet ligjore licencimin e ofruesve të përbajtjeve që transmetohen përmes rrjeteve kablore. Ka pakënaqësi sa i përket kriterëve dhe kriterëve minimale që kërkohen për licencim, gjë që ka çuar në një rritje të shpejtë të kanaleve televizive, disa prej të cilave nuk kanë infrastrukturë të duhur e as resurse të mjaftueshme njerëzore. Këta transmetues mund të mos ishin pajisur me licencë, nëse do të kishte kërkesa më të rrepta<sup>17</sup>, siç është rasti me televizionin privat "*Tribuna Channel*", që u detyrua të mbyllet në mesin e vitit 2019, ndërsa pronarët u mbetën borxh punëtorëve mijëra euro paga.<sup>18</sup> KPM-ja është vonuar në iniciimin e çështjeve dhe në shqiptimin e gjobave për shkeljet ligjore. Për më tepër, emërimi i bordit të KPM-së bëhet drejtpërdrejt nga Kuvendi i Kosovës, për çka ngri-

hen dyshime edhe për përkatësinë politike të anëtarëve të tij.<sup>19</sup>

Në vitin 2018, qeveritë komunale dhe qeveria qendrore shpenzuan 598.917,71EUR në reklama, ku mediet online morën nga buxheti i shtetit 181,23.00 EUR, më shumë para se cilido format tjetër mediatic.<sup>20</sup> Kjo shumë është llogaritur nga përgjigjet e pranuar nga 35 prej 61 institucione publike, pas kërkesës së Asociacionit të Gazetarëve të Kosovës (AGK). Paratë e shtetit, zakonisht ndahen për publikimin e shpalljeve për vende të lira të punës, për njoftime tenderësh ose për fushata të vetëdijesimit të publikut për çështje me interes të gjerë publik, si migrimi, vaksinimi etj. Ndonëse nuk është gjetur ndonjë lidhje e drejtpërdrejtë mes shpenzimeve qeveritare në medie dhe rritjes së ndikimit të tyre në raportimet e medieve, ka pasur diskutime për rrezikun që paraqet kjo dukuri në rritjen e ndikimit të qeverisë në mënyrën e raportimit medial, nëse nuk kontrollohen siç duhet dhe nëse fondet nuk shpërndahen te shumica e medieve.

Hulumtimi i fundit i AGK-së "Paraja Publike e shpenzuar për Media", gjeti se disa institucione publike, veçanërisht ministritë, në mënyrë selektive reklamojnë në medie të ndryshme në internet, gjë që ka ngritur shqetësime serioze. Gjatë periudhës së hulumtimit, reklamata e ministrive qëndruan në faqet e para të medieve online më shumë se dy muaj dhe aty nuk kishte kurrfarë informate. Lexuesi kur klikonte në to ridrejtohej në faqen kryesore të ministrive respektive. Ministritë nuk tregonin ndonjë të arritur të veçantë të institucionit dhe nuk e informonin publikun për ndonjë çështje aktuale të rëndësishme. Ato duket që e reklamonin faqen vetëm për ta rritur shikueshmërinë. Fakti që ministritë financojnë në mënyrë aktive mediet online për ta ngritur shikueshmërinë e faqes së tyre, ngre shqetësime për efektivitetin dhe aftësinë e medieve online për të ruajtur paanësinë në raportimin për atë institucion.<sup>21</sup>

Në Kosovë nuk ka subvencione shtetërore për mediet publike ose private që nga viti 2011. Aktualisht në Kosovë ekziston një kanal i Transmetuesit Publik, RTK2, në gjuhën e pakicave kombëtare, i cili financohet nga buxheti i shtetit. Përgjithësisht RTK2, Qeveria nuk jep subvencione për mediet e komuniteteve dhe për mediet e organi-

15 Ibid. P.27

16 Ibid. p.25.

17 IREX, Media Sustainability Index in Kosovo 2019, p.4. Qasur me 16.12.2019: <https://www.irex.org/sites/default/files/pdf/media-sustainability-index-europe-eurasia-2019-Kosovo.pdf>

18 Insajderi. "Mbyllet Televizioni që u mbeti borxh disa paga ish-punëtorëve" (Television that owed salaries to its ex workers closes). Insajderi Gazetë Online, May 6, 2019. 18.10.2019: <https://insajderi.com/mbyllet-televizioni-qe-u-mbetei-borxh-punetoreve/>

19 IREX, Media Sustainability Index in Kosovo 2019, p.4. qasur: 16 dhjetor, 2019: <https://www.irex.org/sites/default/files/pdf/media-sustainability-index-europe-eurasia-2019-Kosovo.pdf>

20 Association of Journalists of Kosovo [AJK], Paraja publike e shpenzuar në media-2018 (Public Money Spent on media- 2018), p.30-40. Qasur me 12.12.2019: <http://agk-ks.org/wp-content/uploads/2019/05/Asociacioni-i-Gazetar%C3%ABve-f%C3%AB-Kosov%C3%ABs-1.pdf>

21 Ibid, p.37-45

zatave jofitimprurëse. Organizatat ndërkombëtare ofrojnë skema të ndryshme financimi.<sup>22</sup>

Autonomia dhe pavarësia e Transmetuesit Publik është e garantuar me ligj.<sup>23</sup> Megjithatë, kjo pavarësi nuk respektohet dhe as nuk mbrohet në mënyrë efikase. Transmetuesi Publik është shumë i ndjeshëm ndaj ndikimit politik pasi që është i varur nga buxheti i qeverisë dhe ka pak fonde nga marketingu. Pavarësia e tij shpesh është vënë në pikëpyetje nga përfaqësuesit e shoqërisë civile në vend, analistët dhe gazetarët si dhe përfaqësuesit e opozitës, kështu që RTK ka qenë subjekt i kritikave për shkak të anshmërisë politike editoriale, punësimit të pakontrolluar dhe nepotizmit.<sup>24</sup>

Transmetuesi publik RTK mbetet i ndjeshëm ndaj presionit dhe ndikimit politik, pasi ende financohet nga buxheti i shtetit. Gjithashtu, anëtarët e bordit të tij zgjidhen nga parlamenti, gjë që e "rrezikon pavarësinë e tij editoriale dhe institucionale".<sup>25</sup>

Në përpjekjet për të arritur pavarësinë financiare, RTK zbatoi një sistem të mbledhjes së tarifës së licencës përmes Korporatës Energjetike të Kosovës (KEK) ndërmjet viteve 2002-2009. Raportet vjetore të RTK-së treguan se ndërmjet viteve 2005-2009, RTK ishte e pavarur financiarisht nga buxheti i Kosovës.<sup>26</sup> Ndonëse u dëshmuua se kjo ishte një zgjidhje e qëndrueshme për RTK-në, KEK-u e ndërpreu kontratën pas vendimit të Gjykatës Kushtetuese të datës 16 tetor 2009.<sup>27</sup>

Përpjekje për ta rikthyer tarifën e licencës janë bërë përmes projektligjit për financimin e RTK-së që është miratuar nga Parlamenti në vitin 2018. Qëllimi i ligjit ishte rritja e pavarësisë financiare të RTK-së përmes një mekanizmi financiar të përzier, duke aplikuar një abonim prej 2.5 EUR për familje, i cili do të mblidhej përmes faturave të energjisë elektrike si dhe ndarjes së 0.4% nga tota-

li i buxhetit të shtetit. Por, ky ligj nuk është miratuar ende teksa qëndrueshmëria financiare dhe pavarësia e RTK-së vazhdon të jenë të paqëndrueshme.<sup>28</sup>

## A2 Efektet e ligjeve kundër shpifjes te gazetarët

Ligji Civil Kundër Shpifjes dhe Fyerjes<sup>29</sup> Nr. 02/L-65 mbetet ende në fuqi, pavarësisht nismës së vitit 2017<sup>30</sup> që shpifja të konsiderohej vepër penale. Ligji nuk është favorizues për zyrtarët me funksion publik për shkak të fuqisë së pushtetit që përfaqësojnë dhe mundësisë së ndikimit të tyre, por u siguron gazetarëve shkallë të lartë mbrojtjeje ndërsa i mban ata përgjegjës për informacionin që publikojnë vetëm nëse janë në dijeni paraprakisht se materiali i publikuar është i rremë. Ligji i ndalon autoritetet publike që të paraqesin kërkesë për kompensim të dëmit për shpifje ose për fyerje. Zyrtarët publikë mund ta bëjnë këtë vetëm në cilësinë e personit fizik. Për më tepër, Gjykata Kushtetuese ka konfirmuar se deputetët e Kuvendit të Kosovës gëzojnë vetëm imunitet funksional, ndërsa mund të paditen dhe të jenë subjekt i kontrollit nëse bëjnë vepra penale.

Mungojnë të dhënat për numrin e padive të ngritura kundër gazetarëve pasi ato nuk janë të ndara. Në përgjithësi të dhënat janë shumë të izoluar.<sup>31</sup> Mbledhja e të dhënave në institucionet gjyqësore aktualisht është duke kaluar nëpër një proces të transformimit, në përpjekje për të rritur transparencën dhe përgjegjshmërinë përmes zhvillimit të një sistemi të informacionit për menaxhimin e lëndëve (CMIS).<sup>32</sup> Kjo, sipas Arben Hotit koordinatorit për rastet e medieve dhe gazetarëve në gjykatën e Prishtinës,<sup>33</sup> do të konsolidojë të dhënat, do të mundësojë veçimin në kategori dhe përcjelljen e lëndëve gjyqësore në mënyrë kronologjike.

Nuk ka shembuj konkret të raportuar për dispozitat ligjore që përdoren për t'i heshtur gazetarët. Asnjë gazetar nuk është dënua për shkak të veprimtarisë ose raporti-

22 IREX, Media Sustainability Index in Kosovo 2019, p.4. Qasur me 16.12.2019: <https://www.irex.org/sites/default/files/pdf/media-sustainability-index-europe-eurasia-2019-Kosovo.pdf>

23 Komisioni Evropian (KE), Raporti i Kosovës 2019, Bruksel, p. 25, parë më 18 tetor 2019, <https://ec.europa.eu/neighborhood-enlargement/sites/near/files/20190529-Kosovo-report.pdf>

24 Naser Miftari, "E ardhmja e Transmetimit të Shërbimit Publik në Kosovë", Analitika, dokument pune 3/2017, (2017): 34-37. [http://www.analitika.ba/sites/default/files/publikacije/psb\\_Kosovo.pdf?fbclid=IwAR2xKOBm2snPhqLxHjYDMsFNM7ZqHqJ6d0HwBjG3pt5MHpETcp-dUxGrLI](http://www.analitika.ba/sites/default/files/publikacije/psb_Kosovo.pdf?fbclid=IwAR2xKOBm2snPhqLxHjYDMsFNM7ZqHqJ6d0HwBjG3pt5MHpETcp-dUxGrLI)

25 IREX, Indeksi i Qëndrueshmërisë së Medias në Kosovë 2019, p.5. parë më 22.12.2019: <https://www.irex.org/sites/default/files/pdf/media-sustainability-index-europe-eurasia-2019-Kosovo.pdf>

26 Naser Miftari, "E ardhmja e Transmetimit të Shërbimit Publik në Kosovë", Analitika, dokument pune 3/2017, (2017): 34-37. [http://www.analitika.ba/sites/default/files/publikacije/psb\\_Kosovo.pdf?fbclid=IwAR2xKOBm2snPhqLxHjYDMsFNM7ZqHqJ6d0HwBjG3pt5MHpETcp-dUxGrLI](http://www.analitika.ba/sites/default/files/publikacije/psb_Kosovo.pdf?fbclid=IwAR2xKOBm2snPhqLxHjYDMsFNM7ZqHqJ6d0HwBjG3pt5MHpETcp-dUxGrLI)

27 Gjykata Kushtetuese, Lënda nr. Kl 11/09, parë më 07.02.2020: <https://azk.rks-qov.net/ActDetail.aspx?ActID=2922>

28 Komisioni Evropian, Raporti i Kosovës 2019, 29.05.2019, p.26-27, parë më: 20.01.2020 <https://ec.europa.eu/neighborhood-enlargement/sites/near/files/20190529-Kosovo-report.pdf>

29 Ligji Nr. 02/L-65 Ligji civil kundër shpifjes dhe fyerjes, <https://azk.rks-qov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2503>

30 Në vitin 2017 pati një iniciativë që shpifja të bëhet vepër penale, me qëllim kontrollin e medieve të rreme, megjithatë kjo iniciativë nuk kaloi në parlament.

31 Arben Hoti, intervista nga Shkumbin Beqiri, 12 shkurt 2020

32 Blerta Iberdemaj, CMIS, sistemi që do të bëjë institucionet e drejtësisë më transparente dhe llogaridhënëse. 21 nëntor 2018. <https://kallxo.com/shkurt/smil-sistemi-qe-do-te-beje-institucionet-e-drejtise-me-transparente-dhe-llogaridhense/>

33 Arben Hoti, intervista nga Shkumbin Beqiri, 12 shkurt 2020

mit gazetaresk. Gazetarët kanë raportuar kërcënime dhe mënyra të tjera të frikësismit ose kushtëzimit, sikurse refuzimi i kompanive për të reklamuar në medie specifike nëse ndonjë gazetarë publikon ndonjë artikull kritik për ndonjë politikan apo për ndonjërin nga bizneset e mëdha. Kjo përbën kërcënim për sigurinë ekonomike të medieve, pasi pronarët e tyre u nënshtrohen presioneve të jashtme, gjë që krijon mjedis për vetcensurë. Forma tjera të kërcënimeve ndaj gazetarëve, si thirrjet telefonike për frikësim ose kërcënimet me dhunë fizike, ndikojnë negativisht në gatishmërinë e gazetarëve që të raportojnë për krimin e organizuar ose korrupsionin.<sup>34</sup>

Gazetarët mendojnë se sistemi i drejtësisë funksionon në rastet ndaj gazetarëve, mirëpo shtojnë që në rastet ku të përfshirë janë zyrtarët shtetërorë ka tendencë të anëshmërisë.<sup>35</sup> Ata besojnë se në sistemin e drejtësisë është i ulët trajtimi adekuat i rasteve të kërcënimeve kundër gazetarëve. Një hulumtim i zhvilluar nga Organizata e Shoqërisë Civile “Çohu” dhe Këshilli i Medieve të Shkruara të Kosovës (KMSHK), gjeti se prej 175 gazetarëve të anketuar, “vetëm 7% ... besonin se sistemi i drejtësisë do t'i shqyrtonte lëndët e tyre në mënyrë të duhur, kurse 46% ishin të mendimit se kjo është bërë deri në një masë”.<sup>36</sup>

Ligji Nr. 02/L-65 njuh mekanizmat vetërregullues, duke e konsideruar respektimin e vendimeve juridike ose udhëzimeve të KMSHK ose të një rregulloriti tjetër si rrethanë lehtësuese. Më tej, ligji i obligon Gjykatat t'i marrin parasysh masat e marra nga autori, redaktori ose botuesi ose nga dikush që ka ushtruar kontroll mbi përmbajtjen e tij për zbutjen e dëmeve, duke vërtetuar nëse kanë kërkuar falje ose kanë bërë korrigjimin e nevojshëm përpara fillimit të padisë për dëmet e shkaktuara ose sa më parë që të ketë qenë e mundur.

Gazetarët nuk ndjehen të dekurajuar nga ligji për shpifjen. Në fokus grupet me gazetarë, ata ndjehen se me ligje kanë mbrojtje të mjaftueshme sa u përket padive për shpifje, por kur zyrtarët shtetërorë ose figurat publike i kërcënojnë me padi për shpifje, kjo bëhet çështje

shqetësuese dhe mund të ndikojë në rëndimin e punës së tyre, për shkak të presioneve ndaj tyre.<sup>37</sup>

### A3 Mbrojtja ligjore dhe pluralizmi politik në medie

Kushtetuta jep garanci të përgjithshme për pluralizmin e medieve (neni 42), kurse Ligji për Komisionin e Pavarur të Medieve garanton lirinë dhe pluralizmin e medieve audio-vizuele në Kosovë (neni 5). Por, në legjislacionin për mediet (publike e private) nuk ka dispozita specifike që i detyrojnë transmetuesit privat ta respektojnë pluralizmin politik gjatë periudhës jo zgjedhore, përveç Kodit të Sjelljes të KPM-së, i cili i detyron transmetuesit e licencuar t'i mbrojnë e përkrahin raportimet etike dhe të paanshme.

Gjatë periudhave jo-zgjedhore, mediet duhet ta respektojnë Kodin e Sjelljes, të miratuar nga KPM-ja dhe KMSHK-ja, që thonë se mediet nuk duhet të jenë të njëanshme në paraqitjen e aktiviteteve të partive politike. Megjithatë, sipas KIPRED-it, Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme ka mangësi, pasi ai “nuk i përcakton në mënyrë të qartë veprimet e ndërmarra para fushatës<sup>38</sup> nga partitë politike, të cilat i fillojnë më herët fushatat e tyre. Në 2019, kur fushata zgjedhore ishte vendosur të zgjaste vetëm 10 ditë, partitë politike i kishin filluar aktivitetet elektorale që nga data e shpalljes së zgjedhjeve.<sup>39</sup> Gjithashu, janë vërejtur mospërputhje të vogla përfaqësimi në medie të partive të caktuara politike.<sup>40</sup>

Detyrim i të gjitha medieve<sup>41</sup> sipas Ligjit Nr. 003/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme, është sigurimi i qasjes së barabartë për të gjitha subjektet politike dhe respektimi i Kodit të Sjelljes (KIS) të hartuar nga Këshilli të Medieve të Shkruara të Kosovës (KMSHK),<sup>42</sup> i cili i obligon të gjitha mediet të aplikojnë të njëjtat standarde etike edhe gjatë periudhës jo-zgjedhore. Partitë politike nuk kanë qasje të

34 BIRN, *Presioni i Pafund: raportimi i mediave të Kosovës për krimin e organizuar dhe korrupsionin* [Endless Pressure: reporting of Kosovo media on organized crime and corruption], 2018, [https://balkaninsight.com/wp-content/uploads/2018/01/Kosovo-country-report-aib.pdf?fbclid=IwAROR4sBuKNfZOZwT8aZOAb3PKn0ca79S7\\_mmfQPA\\_Zs66tu637HEMvERmFzq](https://balkaninsight.com/wp-content/uploads/2018/01/Kosovo-country-report-aib.pdf?fbclid=IwAROR4sBuKNfZOZwT8aZOAb3PKn0ca79S7_mmfQPA_Zs66tu637HEMvERmFzq)

35 3 fokus grupe me gazetarë nga media e shtypur, transmetuese, OJQ dhe media online, zhvilluar nga Liron Kafexholli & Shkumbin Beqiri (11, 13, 26 dhjetor 2019).

36 *Cohu. Liria e shprehjes, Media dhe informacioni në Kosovë Një vlerësim i bazuar në treguesit e Këshillit të Evropës për median në Demokraci*, p.26. [https://crd.org/wp-content/uploads/2018/12/Freedom\\_of\\_Expression\\_Media\\_and\\_Information\\_in\\_Kosovo\\_529396.pdf](https://crd.org/wp-content/uploads/2018/12/Freedom_of_Expression_Media_and_Information_in_Kosovo_529396.pdf)

37 *Fokus grupi me gazetarët nga mediat e shtypura, transmetuesit, OJQ-të dhe mediat online, zhvilluar më 11.12.2019.*

38 *Mentor Agani, Gent Gjokollari et. al., Sistemi elektorale dhe partitë në Kosovë një perspektivë e zhvillimit të demokracisë së brendshme të partis, KIPRED, 2015, Prishtinë, P. 9-10. . parë më: 12 Shkurt 2020*

39 *Demokracia në veprim, Deklaratë Preliminare, 2019, Prishtina, P.8* [http://kdi-kosova.org/wp-content/uploads/2019/10/FINAL\\_Deklarata-preliminare-p%C3%ABr-zgjedhjet-e-parakohshme-p%C3%ABr-Kuvendin-e-Kosov%C3%ABs\\_FINAL.pdf](http://kdi-kosova.org/wp-content/uploads/2019/10/FINAL_Deklarata-preliminare-p%C3%ABr-zgjedhjet-e-parakohshme-p%C3%ABr-Kuvendin-e-Kosov%C3%ABs_FINAL.pdf)

40 *Ibid.* p. 3

41 *Ligji No. 003/L-073, “Media” do të thotë të gjitha televizionet dhe radiostacionet që transmetojnë në territorin e Kosovës dhe të cilët janë të licencuara nga Komisioni i Pavarur për Media, duke përfshirë edhe mediat e shkruara;*

42 *KMSHK. Udhëzues për Kodin e Medive të Shkruara të Kosovës (Code of Kosovo Press). Prishtina. Mars 2015. . parë më 18 Mars 2020* <http://presscouncil-ks.org/wp-content/uploads/2015/04/Udh%C3%ABzues-p%C3%ABr-Kodin-e-Medive-t%C3%AB-Shkruara-t%C3%AB-Kosov%C3%ABs-mars2015.pdf>

drejtë dhe të barabartë në medie gjatë periudhës zgjedhore, pasi që tregu medial është i tejkopur me përmbajtje politike dhe partitë kryesore politike konsumojnë më shumë kohë të transmetimit.<sup>43</sup> Janë raportuar mospërputhje në mbulimin e aktiviteteve politike në transmetuesit radio-televiziv dhe për afërsinë e dukshme të medie me subjekte të caktuara politike. Gjatë zgjedhjeve në 2019, RTK tregoi një mbulueshmëri të balancuar në televizion por në faqen e lajmeve online dhe në Facebook i dha mbulueshmëri më të madhe dhe pozitive PDK-së, dhe më pak mbulueshmëri për partitë tjera, duke qenë më negative ndaj LDK-së.<sup>44</sup>

Nuk ka ndonjë detyrim specifik për autoritetin rregullativ që të mbrojë pluralizmin politik në medie gjatë periudhës jo-zgjedhore. Sidoqoftë, në bazë të Ligjit Nr. 003/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme, (neni 49-53, & 109), KPM-ja<sup>45</sup> është e detyruar të monitorojë pluralizmin politik përmes qasjes në reklama (falas dhe me pagesë) të ofruara për secilin subjekt politik nga secili transmetues, t'i mbikëqyrë shkeljet e medie, trajtojë ankesat dhe t'i administrojë dhe sanksionojë ato gjatë periudhës zgjedhore. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) është organi përgjegjës për paraqitjen e ankesave (përfshirë shkeljet e pluralizmit politik) te KPM-së. Në vitin 2019, KPM-ja ka gjetur raste të shkeljes<sup>46</sup> së Neni 52<sup>47</sup> gjatë monitorimit të zgjedhjeve të parakohshme në katër komuna<sup>48</sup>. Sidoqoftë, efikasiteti i tyre është zvogëluar, për shkak të mungesës së burimeve, pasi që KPM-ja është e vonuar në shqiptimin e gjobave, ndërsa KMSHK-ja nuk ka burime për t'i hetuar shkeljet e mundshme<sup>49</sup>.

#### A4 Liria në punë, garancitë dhe praktikën e asociacioneve

Shteti nuk kërkon asnjë formë të licencimit për të punuar si gazetar. Gjatë vitit 2019 ka pasur dy raste të njohura të mohimit të punës së gazetarëve të raportuara në AGK. Një kameraman ishte penguar ta kryejë detyrën e tij nga persona të panjohur në kuvendin zgjedhor të një nëndege të partisë politike, LDK-së<sup>50</sup>. Gjatë një eventi në fshatin Dubravë, edhe një gazetar tjetër u pengua nga oficerët korrektues, me ç'rast u parandalua ta intervistonte një ish-pjesëtar të UÇK-së, njëkohësisht ish i burgosur në institucionin korrektues në Dubravë.<sup>51</sup>

Gazetarët kanë të drejtë dhe janë të lirë të bashkohen në një organizatë, siç u garantohet nga Kushtetuta, Ligji Nr. 03/L-1212 për Punën<sup>52</sup>, dhe Ligji Nr. 04/L-011 për Organizimin Sindikal në Kosovë<sup>53</sup>. Aktualisht ekzistojnë dy shoqata të gazetarëve, Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës (AGK) (420 anëtarë) dhe Shoqata e Gazetarëve Serbë në Kosovë (120 anëtarë). Ekziston edhe Asociacioni i Medieve të Pavarura Elektronike të Kosovës (AMPEK). Gjatë vitit 2019, nuk është raportuar asnjë rast presioni mbi shoqatat e gazetarëve dhe të medie.

Punëtorët e Transmetuesit Publik, RTK-së janë të vetmit punëtorë medial të organizuar në sindikata. Aktualisht në këtë transmetues ekzistojnë tri organizata sindikale: Sindikata e Pavarur e RTK-së, Sindikata e Punëtorëve të RTK-së, Sindikata e Punëtorëve të Radios. Nuk ka asnjë institucion të veçantë për mbrojtjen e së drejtës për punë të gazetarëve.<sup>54</sup> Meqenëse nuk ka sindikata që i përfaqësojnë interesat e të gjithë gazetarëve në Kosovë, AGK-ja shërben si pikë kryesore kontakti për adresimin e shkeljeve të të drejtave të tyre. Në disa raste, AGK-ja ka vepruar si ndërmjetës midis gazetarit dhe institucionit.<sup>55</sup>

Nga intervista mbajtur me një gazetar të RTK-së është thënë se pas formimit të sindikatës së dytë të RTK-së në

43 Mentor Agani, Gent Gjilkoll et al., Sistemi elektoral dhe partik në Kosovë një perspektivë e zhvillimit të demokracisë së brendshme të partisë, KIPRED, 2015, Prishtinë, P. 86, . parë më 18 shkurt 2020 [http://www.kipred.org/repository/docs/Kosovo\\_national\\_study\\_english\\_146126.pdf](http://www.kipred.org/repository/docs/Kosovo_national_study_english_146126.pdf)

44 European Union, Election Observation Mission Kosovo 2019, 6 October 2019, P.30-31, [http://www.epgencms.europarl.europa.eu/cmsdata/upload/1e4f1465-9cdd-4565-a837-a0487b092e51/Kosovo\\_early-legislative-elections\\_6-October-2019\\_final-report.pdf](http://www.epgencms.europarl.europa.eu/cmsdata/upload/1e4f1465-9cdd-4565-a837-a0487b092e51/Kosovo_early-legislative-elections_6-October-2019_final-report.pdf), parë më: 20 February 2020

45 Ligji nr. 04/L-44 për komisionin e pavarur të mediave (law no. 04/L-044 on the independent media commission). Official gazette of the republic of kosova / no. 5 / 05 april 2012. Prishtina. <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2809>

46 IMC. "Raportimi gjatë periudhës zgjedhor. Zgjedhjet e jashtëzakonshme në komunat Mitrovica Veriore, Zubin Potok, Leposaviq, dhe Zvečan. Periudha e monitorimit: 3 – 19 maj 2019, 2019. Prishtinë. [https://www.kpm-ks.org/assets/cms/uploads/files/1561381040\\_0559%20qjgjt.pdf](https://www.kpm-ks.org/assets/cms/uploads/files/1561381040_0559%20qjgjt.pdf)

47 Neni 52: Ndalimi i përfshirjes në Media

48 Mitrovicë e Veriut, Leposaviq, Zubin Potok dhe Zvečan

49 Komisioni Evropian (KE), Raporti i Kosovës 2019, Bruksel, p. 25, parë më 20 nëntor 2019. <https://ec.europa.eu/neighborhood-enlargement/sites/near/files/20190529-Kosovo-report.pdf>

50 AGK, pengesë në kryerjen e detyrës – Enis Misimi, Prishtinë, 17 qershor 2019. <http://agk-ks.org/raste/pengim-ne-kryerje-te-detyres-enis-misimi-prishtine-17-07-2019/>

51 AGK, pengesë në kryerjen e detyrës – Mirind Behluli, Prishtinë, 23 maj 2019. <http://agk-ks.org/raste/pengim-ne-kryerje-te-detyres-mirind-behluli-prishtine-23-05-2019/>

52 Ligji nr. 03/L-212 i punës (law no.03/L –212 on labour). Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës / Prishtinë: viti v / nr. 90 / 01 december 2010. <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2735>

53 Ligji nr. 04/L-011 për organizimin sindikal në Kosovë (law no. 04/L-011 for organizing trade union in Kosovo) Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës / no. 11 / 26 gusht 2011, Prishtinë. <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2754>

54 Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim Evropian, Liria e Medias dhe Siguria e Gazetarëve në Kosovë. Qershor 2014. Prishtinë. <https://www.osce.org/Kosovo/122390?doenload=true>

55 IREX, Media sustainability Index, P. 9 <https://www.irex.org/sites/default/files/pdf/media-sustainability-index-europe-eurasia-2019-kosovo.pdf>

vitin 2011 – që gazetari dyshon që ka lidhje me menaxhmentin- pati një ndryshim në ambientin e punës. Sipas gazetarit, anëtarët e sindikatës së dytë janë ngritur në detyrë për një periudhë të shkurtër. Ndërsa kërkesat e shumta të disa gazetarëve për avancim janë refuzuar pa dhënë përgjegjje konkrete se përse janë refuzuar, përkundër përvojës në terren, shpërblimeve të fituara dhe trajnimeve profesionale.<sup>56</sup>

Me ligj, gazetarët janë të lirë të organizohen në sindikata, por për shkak të pasigurisë ekonomike, frikës së humbjes të vendeve të punës, masave ndëshkimore, mungesës së funksionimit efikas të mekanizmave mbrojtës si Inspektorati i Punës ashtu edhe zvarritjes së lëndëve në Gjykata, gazetarët e medieve private nuk kanë arritur të organizohen në sindikata.<sup>57</sup> I intervistuari përmendi këto si arsye pse gazetarët e medieve private nuk mund të iniciojnë themelimin e organizatave të tyre sindikale.

Këshilli i Medieve të Shkruara të Kosovës (KMSHK) është një organ vetë-rregullues që e ka nisur punën në vitin 2005, i cili ka në juridiksionin e vet vetëm shtypin e shkruar. Por, pas ndryshimit të peizazhit medial dhe pas tendencës që gazetaret të publikohen vetëm në internet, KMSHK-ja ka filluar t'i përfshijë edhe portalet online. KMSHK-ja konsiderohet si rregullatori më i pavarur nga ndikimet politike, pasi zgjedhja e bordit të tij nuk varet nga Kuvendi, siç ndodh me bordin e KPM-së<sup>58</sup>. Nuk ka pasur raportime për presione mbi përfaqësuesit e KMSHK-së, ndonëse ky rregullator është përballur me kritika për besueshmëri të dobët dhe për shpërfillje të ankesave. Aktualisht, anëtarët të KMSHK-së janë 33 gazeta dhe media online. Gjatë periudhës maj 2018-prill 2019, KMSHK-ja i ka pranuar 92 ankesa ndaj anëtarëve të tij, shumica prej të cilave kanë pretendime për shkelje të etikës.<sup>59</sup>

## A5 Mbrojtja ligjore e burimeve të gazetarëve

Ligji Nr. 04/L-137 për Mbrojtjen e Burimeve të Gazetarisë<sup>60</sup>, i cili vlen posaçërisht për gazetarët dhe garanton konfidencialitetin e burimeve të tyre, mbështetet edhe nga

56 Anonim 3, gazetar RTK, Intervistë nga Liron Kafexholli, 4 qershor 2020

57 Dren Berishaj, "Organizatata e punës së Kosovës duhet të transformohen rrënjësisht", Prishtina Insight, 1 maj 2017, parë më: 4 janar 2020. <https://prishtinainsight.com/Kosovos-labor-organizations-need-radically-transformed-mag/>

58 Naile Krasniqi, ish drejtoreshë ekzekutive e KPM, intervistuar nga Liron Kafexholli, 14 nëntor 2019

59 CoHu. Media Monitor Online 2018-2019. Prishtinë. 2019. P. 9. [http://www.cohu.org/repository/docs/22\\_-\\_Online\\_Media\\_Monitor\\_-\\_ALB\\_-\\_04\\_12591.pdf](http://www.cohu.org/repository/docs/22_-_Online_Media_Monitor_-_ALB_-_04_12591.pdf) p.9

60 Ligji Nr. 04/L-137 për Mbrojtjen e Burimeve të Gazetarëve [Law No. 04/L-137 on Protection of Journalists Sources] <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=8864>

Ligji Nr. 06/L-085 për Mbrojtjen e Sinjalizuesve<sup>61</sup>, i cili e rregullon çështjen e mbrojtjes së burimeve dhe i obligon zyrtarët publikë që t'i mbrojnë sinjalizuesit dhe të mos i shpërndajnë informatat tek palët e treta. Në vitin 2019 nuk janë raportuar raste që gazetarët të jenë urdhëruar t'i bëjnë publike burimet e tyre. Megjithatë, sipas ligjit, Gjykata ka të drejtë të kërkojë nga gazetarët informata në raste të veprave penale të kryera, në rastet e kërcënimit me jetë të një personi apo të më shumë personave dhe në rast të kërcënimit për shtetin<sup>62</sup>.

Gjatë seancave të fokus grupeve, gazetarët kanë thënë se ata ndihen të sigurt për ruajtjen e marrëdhënieve me burimet e informacionit në sektorin publik ose në sektorin privat<sup>63</sup>. Gjatë vitit 2019, nuk ka pasur raportime për ndonjë rast të presionit të zyrtarëve qeveritarë ndaj gazetarëve për të zbuluar burimet e tyre.<sup>64</sup> Sipas gazetares hulumtuese Adriana Thaçi, korniza ligjore mbrojnë gazetarët dhe burimet e tyre, ndërsa mungesën e njohurive të gazetarëve mbi ligjin e sheh si të vetmen mangësi të mundshme.<sup>65</sup>

## A6 Mbrojtja e së drejtës për qasje në informata

Ligji 06/L-081 për Qasjen në Dokumente Publike<sup>66</sup> e rregullon çështjen e përdorimit të dokumenteve zyrtare dhe informacionit, duke i dhënë secilit person qasje të barabartë në dokumentet publike, të prodhuara, të pranuar, të mbajtura apo të kontrolluara nga institucionet publike. Ligji i detyron institucionet publike që brenda një afati të caktuar të japin informatat e kërkuara (afati i përgjigjes është 7 ditë). Institucionet mund të refuzojnë të japin informacione ose dokumente vetëm në rastet kur dëmi i shkaktuar interesit të mbrojtur e tejkalon interesin publik për qasje në atë dokument (Neni 17).<sup>67</sup>

61 Ligji nr. 06/L-085 për mbrojtjen e sinjalizuesve [Law no. 06/L-085 on protection of whistleblowers]. Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës / nr. 22 / 18 dhjetor 2018, Prishtinë 21. <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=18303>

62 Besim Kelmendi, Prokuror i Shtetit, intervistuar nga Liron Kafexholli, 6 nëntor 2019

63 3 fokus grupe me gazetarë nga media e shtypur, transmetuese, OJQ dhe media online, e realizuar nga Liron Kafexholli & Shkumbin Beqiri (11, 13, 26 December 2019).

64 Besim Kelmendi, Prokuror i Shtetit, intervistuar nga Liron Kafexholli, 6 nëntor 2019

65 Adriana Thaçi, Gazetare hulumtuese, intervistuar nga Liron Kafexholli, 28 maj 2020

66 Ligji nr. 06/L-081 për qasje në dokumente publike (laë no. 06/L-081 on access to public documents). Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës / nr. 13 / 04 korrik 2019, Prishtinë 19. <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=20505>

67 Behet testi i 'dëmtimit dhe interesit publik'



Gazetarët përbëjnë shumicën e palëve që kërkojnë dokumente (44% e kërkesave)<sup>68</sup>. Në vitin 2018, nga autoritetet shtetërore janë refuzuar 138 prej gjithsej 2,350 kërkesave të paraqitura për qasje në dokumentet zyrtare (të dhënat nuk janë të veçuara).<sup>69</sup> Hulumtimi i Demokracisë në vitin 2018 zbuloi se mbi 78% e institucioneve nuk u lejojnë qasje gazetarëve.<sup>70</sup>

Gazetarët kanë deklaruar se autoritetet nuk janë transparente dhe përdorin taktika të ndryshme për të dekurajuar qasjen në dokumente, duke e stërzgatur procesin, duke i endur dhe drejtuar ata nga një institucion te tjetri dhe duke u dërguar informacione jo specifike por me shumicë, në mënyrë që t'u vështirësohet gjetja e përgjigjes së qartë.<sup>71</sup>

Një nga gazetarët pjesëmarrës në fokus grupin për këtë raport ka treguar një përvojë të tij gjatë kërkimit të dokumenteve publike. Ai kishte kërkuar në Zyrën e Presidentit informata për shpenzimet e udhëtimit për gjashtë muajt e fundit, por përgjigja ndaj kërkesës së tij ishte zvarritur shumë. Pas këmbënguljes së vazhdueshme për të marrë të dhënat e kërkuara, Zyra e Presidentit ia kishte ofruar të dhënat për udhëtimet gjatë 10 viteve të fundit, të cilat ishin pothuajse të padobishme. Kur kishte kërkuar që të dhënat të ndaheshin sipas viteve, Zyra e Presidentit i ishte përgjigjur se nuk mbajnë të dhëna të ndara sipas kornizës kohore që kishte kërkuar gazetari. I vënë në presion të afatit për publikimin e artikullit, gazetari kishte hequr dorë nga mbledhja e të dhënave që kishte kërkuar, duke iu pamundësuar kështu realizimi i artikullit.

Gazetarët kanë qasje në seancat e Gjykatave, përveç në çështjet gjyqësore kur gjykatësi kërkon masa mbrojtëse për palët e akuzuara apo për palët e dëmtuara. Megjithatë, aktualisht ka një përpjekje për të rishikuar

Kodin e Sjelljes<sup>72</sup>, gjë që do të kufizonte mundësinë që gazetarët të raportojnë për seancat gjyqësore dhe do t'i detyronte ata të raportojnë vetëm për vendimin përfundimtar të gjykatës. Këto përpjekje kanë hasur në kritika të gazetarëve dhe të përfaqësuesve të medie, të cilët mendojnë se kjo do t'i dekurajonte përpjekjet për zhvillim të gazetarisë hulumtuese.<sup>73</sup> Gjatë vitit 2019, nuk ka pasur rastë të raportuara që gazetarëve nuk u është lejuar qasje në seancat e hapura gjyqësore.

Për të siguruar qasje në seancat parlamentare, gazetarët duhet të akreditohen nga Sekretari i Kuvendit.<sup>74</sup> Gazetarët pjesëmarrës në fokus grupe kanë deklaruar se parlamenti ishte kryesisht institucioni më i hapur<sup>75</sup>. Gjetje të ngjashme kanë dalë edhe nga një hulumtim i kryer nga "Çohu" dhe KMSHK-ja, ku gazetarët e kanë vlerësuar parlamentin si institucionin më transparent.<sup>76</sup>

Qeveria vlerësohet si institucioni më i paqashtëm, pasi informacionet jepen në bazë të rëndësisë/ndikimit të raportimit. Si pasojë e zvarritjes së përgjigjeve nga qeveria në informacionet e kërkuara, disa gazetarë janë dekurajuar dhe kanë hequr dorë nga kërkesat e tyre.<sup>77</sup> Gazetarët pjesëmarrës në fokus grup kanë konfirmuar se taktika të ndryshme të dekurajimit për të siguruar qasje në të dhëna e dokumente publike janë zbatuar kryesisht nga institucionet qeveritare. Ata kanë treguar se ishin drejtuar nga një institucion të tjetri, se u ishin dhënë të dhëna të shpërndara apo të parëndësishme ose u ishin zvarritur përgjigjet për kërkesat e tyre.<sup>78</sup>

68 Zyra e Kryeministrit. Raport gjithëpërfshirës për institucionet publike për realizimin e së drejtës për qasje në dokumente publike. Mars 2018. Prishtinë. [69 Të dhënat për vitin 2019 pritet të publikohen në Mars 2020](http://kryeministri-ks.net/wp-content/uploads/2019/04/RAPORT-GJITH%C3%8BP%C3%8BRFSHIR%C3%8BS-14-03-2019-2...pdf?_cf_chl_jschl_tk_=67dd8251e68760fb7cd28d3264c4d12a84bb95ab-1578639788-0-AZxslCG9pF5NjicBLLRGIeGRMnHJKn-iajORSVlloP9mnT6qRttkLMLKIdnCN0EgGp8WuGMi4Y6it3ELCukVIALtFqF6zi6-QDNie12OXVKQ0aJ5SNMeFZn16b4EFkijXenN82Pr_Be1aL6MfNXP1ORj8DckmZmc69KRqZSCGoD63T-NAgwVdMfsvNjmcz2XY0EYEUUR3ddLKSAtmq-0X27REYUu6wRtd3hQx4ZvOQ4KIY1cEkkNhs16Fd7E-8294FfYzefRNz61p8z2GXHV73_s9KimS8g882KsD42c0preR7FpyLZ7DpbR9vKbKBCciUMAzxlOGS5rN5wRbS_JaNaKzi77NEs1aR37NfN8ESC4bsCv63i0W7bYUlcax6JJA</a></p></div><div data-bbox=)

70 Demokracia Plus. "Raporti për ofrimin e qasjes në dokumente publike, përgjigje sipërfaqësore në mungesë të të dhënave". 2018. <http://www.dplus-ks.org/lajmet/2018/raporti-i-institucioneve-publike-me-ofrimin-e-qasjes-ne-dokumente-publike-per-gjigje-siperfaqesore-mungese-te-dhenave/>

71 Fokus grupi me gazetarë nga media e shtypur, transmetuese, OJQ dhe media online, e realizuar nga Liron Kafexholli & Shkumbin Beqiri (11 dhjetor 2019).

72 Republic of Kosovo. KKPM-2010/01 Kodi i sjelljes për shërbimet mediale audiovizuale në Republikën e Kosovës [Code of Conduct for Audio-visual Media Services in the Republic of Kosovo]. Prishtina, 2010. [http://kpm-ks.org/assets/cms/uploads/files/Leqjisiacioni/12925921010176.pdf?fbclid=IeAR058ge1KGvTsbVARIj2Cx5relkTqULUQFDHl\\_Pehc63KYVYEdnPePee](http://kpm-ks.org/assets/cms/uploads/files/Leqjisiacioni/12925921010176.pdf?fbclid=IeAR058ge1KGvTsbVARIj2Cx5relkTqULUQFDHl_Pehc63KYVYEdnPePee)

73 Gazeta Express, "Flutura Kusari: Nëse ndryshohet kodi i sjelljes, KPM shëndërrohet në censurues të mediave" 22 janar 2020. [https://www.gazetaexpress.com/kusari-nese-ndryshohet-kodi-i-sjelljes-kpm-ja-shnderrohet-ne-censurues-te-mediave/?fbclid=IeAR2ZY5i2avL-6GKjuWbhGavTyemxj\\_D56QII\\_UpQDz39d4-X8I-a6ElyuE](https://www.gazetaexpress.com/kusari-nese-ndryshohet-kodi-i-sjelljes-kpm-ja-shnderrohet-ne-censurues-te-mediave/?fbclid=IeAR2ZY5i2avL-6GKjuWbhGavTyemxj_D56QII_UpQDz39d4-X8I-a6ElyuE)

74 Assembly, Rules of Procedure of the Assembly of the Republic of Kosovo, Prishtinë, 29 prill 2010. <http://www.votaimo.org/Uploads/Data/Documents/Rregullorja-BavpxHzS6x.pdf>

75 3 fokus grupe me gazetarë nga media e shtypur, transmetuese, OJQ dhe media online, e realizuar nga Liron Kafexholli & Shkumbin Beqiri (11, 13, 26 dhjetor 2019).

76 Çohu. Liria e shprehjes, media dhe informacioni në Kosovë Një vlerësim i bazuar në treguesit e Këshillit të Evropës për medianë në një demokraci, p.26. [https://crd.org/wp-content/uploads/2018/12/Freedom\\_of\\_Expression\\_Media\\_and\\_Information\\_in\\_Kosovo\\_529396.pdf](https://crd.org/wp-content/uploads/2018/12/Freedom_of_Expression_Media_and_Information_in_Kosovo_529396.pdf)

77 AGK, "Dokumente publike, të mbyllura për publikun" Prishtinë, 04 dhjetor 2018. <http://aak-ks.org/dokumentet-publike-te-mbyllura-per-publikun/>

78 Fokus grupe me gazetarë nga media e shtypur, transmetuese, OJQ dhe media online, e realizuar nga Liron Kafexholli & Shkumbin Beqiri (11 Dhjetor 2019).

# B

## Pozita e gazetarëve në redaksi, etika profesionale dhe niveli i censurës

### **B1 A është abuzuar me pozitën ekonomike të gazetarëve për të kufizuar lirinë e tyre?**

Pozita relativisht e dobët ekonomike e gazetarëve krijon rrethana për abuzime dhe për kufizime të lirisë së gazetarëve në raportim. Gazetarët e medieve më të mëdha kanë kontrata dhe paguhen rregullisht, por vetëm Transmetuesi Publik RTK nënshkruan edhe kontrata me kohë të pacaktuar (të përhershme pune) pas një përvoje disa vjeçare të gazetarëve. Ndryshe qëndron çështja në mediet private, ku gazetarët shpesh kanë kontrata afatshkurtra ose nuk kanë fare kontrata pune. AGK ka reaguar gjatë vitit 2019 ku bashkë me Inspektoriatin e Punës kanë marrë hapa për inspektimin e të gjitha mediave<sup>79</sup>. Rezultatet e publikuara nga inspektoriatin e punës tregojnë që nga 34 medime e inspektuara të punësuar ishin gjithsej 1896 persona (719 meshkuj dhe 1179 femra) ku 21 persona nuk kishin kontrata pune gjithashtu në raport thuhet se janë evidentuar 83 raste ku të drejtat e puntorëve janë shkelur ( mos pagesë e rrogës, orarë i tejzgatur apo mungesa të kontratave<sup>80</sup>. Shumica e gazetarëve, gjatë diskutimeve në fokus grup, kanë thënë se nuk kanë mbroj-

79 AGK, AGK dhe Inspektorati i Punës me nismë dy mujore për mbrojtjen e të drejtave të gazetarëve, 1 janar 2019, casur: 18 shkurt 2020

80 Ministria e Punës dhe Mirëqenjes Sociale. Raportohet mbi gjendjen e punëtorëve medial në Kosovë, 29 gusht 2019

tje të duhur sociale, pasi nuk kanë sigurim parësor.<sup>81</sup> Paga mesatare e tyre është nën pagën mesatare të vendit dhe vetëm gazetarët e medieve më të mëdha paguhen rregullisht, ndërsa të tjerët shpesh paguhen me vonesa ose paguhen me para të gatshme, ndërsa kontributet nuk u paguhen fare.

Kushtet e punës së gazetarëve janë të dobëta. Në gjendje më të vështirë besohet se janë mediet online, të cilat konsiderohen si “*ndër problemet më imediale në skenën e medieve kosovare*”<sup>82</sup>. Gazetarët që kanë marrë pjesë në fokus grupe, kanë thënë se orari i tyre i punës shpesh nuk respektohet, nuk kompensohen fare për orët shtesë të punës, kurse shumica e gazetarëve në media online shpesh e kanë vetëm një ditë pushim në javë<sup>83</sup>. Problemet kryesore të gazetarëve janë: jostabiliteti në vendet e punës, pagat e ulëta, mungesa e kontratave të punës, mungesa e sigurimit shëndetësor, etj. Kjo pasiguri rritet edhe më shumë me shtimin e numrit të gazetarëve të rinj të diplomuar, të cilët e rrisin edhe më shumë presionin e tregut të punës mbi gazetarët ekzistent. Gazetarët që kërkojnë përmirësimin e kushteve të punës shpesh ballafaqohen me kërcënime se do të zëvendësohen me gazetarë të rinj që kërkojnë punë, të cilët janë të gatshëm të punojnë në kushte më të këqija. Në situatë të vështirë janë edhe gazetarët e rinj, të cilët shpesh hyjnë në tregun e punës si praktikantë pa pagë, të cilat zgjasin për periudha të pacaktuara duke mos pasur garanci për punësim.<sup>84</sup> Megjithë këto probleme, gazetarët kanë thënë se shohin një përmirësim të vogël dhe me hapa shumë të ngadaltë të gjendes së tyre ekonomike.

**Gazetarët kanë raportuar për disa raste të bren-gosjes në lidhje me gjendjen e tyre ekonomike, e cila ka të bëjë kryesisht me kontratat e tyre të punës, të cilat shpesh janë kontrata pune një vjeçare ose gjashtë mujore, gjë që krijon ndjenjën e vazhdueshme të pasigurisë se a do t’iu vazhdohet kontrata. Një gazetar ka treguar se punëdhënësi i tij i kishte thënë se ai do ta kishte një kontratë që e siguronte pozitën e tij në medium, por gazetari nuk e kishte parë kurrë**

**atë kontratë dhe nuk e kishte nënshkruar kontratën ndonjëherë.<sup>85</sup>**

## **B2 Cili është niveli i pavarësisë editoriale nga pronarët e medieve dhe nga organet drejtuese?**

Në shumicën e medieve private, sidomos në ato më të vogla, nuk ka struktura të brendshme organizative të qarta. Në mediet më të vogla aplikohen fare pak rregullat e pavarësisë editoriale, ndërsa në mediet private më të mëdha, në ato kryesoret, politikat editoriale përcaktohen nga pronarët e tyre. Së këndejmi, del se pavarësia editoriale në mediet private është e ulët dhe gazetarët kanë vetëm një shkallë të caktuar të lirisë.<sup>86</sup> Gazetarët nuk janë në gjendje të japin shpjegim për nivelin e saktë të pavarësisë editoriale që e gëzojnë në mediet ku punojnë. Ata thonë se kanë një liri të madhe të propozojnë tema, por liria e tyre për realizimin e temave që i propozojnë ngushtohet për shkak të disa rrethanave, siç janë: mungesa e mbrojtjes nga punëdhënësi në rastet që hasin në probleme gjatë raportimit të tyre. Ata thonë se pronarët kanë ndikim *drejtpërdrejtë* në punës së tyre, por më shumë ndikim kanë nga grupe të caktuara joformale gjatë realizimit të temave, prandaj ata vetë-censurohen.

Vetëm disa prej medieve më të mëdha private i kanë kodet e brendshme të etikës, kështu që gazetarët përpiqen t’i respektojnë kodet e përgjithshme të etikës së medieve audio-vizive<sup>87</sup> dhe të medieve të shtypura<sup>88</sup>. Gazetarët e medieve online raportuan se nuk kishin inkurajim të veçantë nga menaxhmenti për t’i zbatuar kodet etike. Janë 28 anëtarë të KMSHK-së<sup>89</sup>, kurse në periudhën prill 2018-maj 2019, KMSHK-ja i ka pranuar 92 ankesa për shkelje të kodit të tyre etik.<sup>90</sup>

81 3 fokus grupe me gazetarë nga media e shtypur, transmetuese, OJQ dhe media online, e realizuar nga by Liron Kafexholli & Shkumbin Beqiri (11, 13, 26 dhjetor 2019).

82 [TASCO]. Raporti i Semaforave ‘2017 Kosova \* Raporti i Monitorimit të’ Udhëzimeve të BE-së për Lirinë e Medias dhe Integritetin e Mediave 2014-2020 për 2017. Faqe 9. qasur: 5 janar 2020. [https://ec.europa.eu/ neighbourhood-enlargement/sites/near/files/media\\_traffic\\_lights\\_report\\_kosovo.pdf](https://ec.europa.eu/ neighbourhood-enlargement/sites/near/files/media_traffic_lights_report_kosovo.pdf)

83 3 fokus grupe me gazetarë nga media e shtypur, transmetuese, OJQ dhe media online, e realizuar nga by Liron Kafexholli & Shkumbin Beqiri (11, 13, 26 dhjetor 2019).

84 Ngadhnjim Avdyli, SHKELJET ME SHUMICË TË TË DREJTAVE TË GAZETARËVE, 23 tetor 2018. parë më: 10 janar 2020. <https://kosovotvopointzero.com/en/shkelje-me-bollek/>

85 Fokus grup me gazetarë nga media e shtypur, transmetuese, OJQ dhe media online, zhvilluar nga Liron Kafexholli & Shkumbin Beqiri (26 dhjetor 2019)

86 Ibid.

87 Republic of Kosovo. KKPM-2010/01 Kodi i sjelljes për shërbimet mediale audiovizuale në Republikën e Kosovës [Code of Conduct for Audio-visual Media Services in the Republic of Kosovo]. Prishtina, 2010. [http://kpm-ks.org/assets/cms/uploads/files/Legjislatimi/1292592101076.pdf?fbclid=IwAR058qeIKGyTSbVARI\\_12Cx5reIKTguLTUQrDHI\\_Pwhc63KYVYEdwnPwPeo](http://kpm-ks.org/assets/cms/uploads/files/Legjislatimi/1292592101076.pdf?fbclid=IwAR058qeIKGyTSbVARI_12Cx5reIKTguLTUQrDHI_Pwhc63KYVYEdwnPwPeo)

88 Këshilli i Shtypit i Kosovës. Kodi i etikës për media të shkruara në Kosovë [Press Code for Kosovo]. Prishtina, 2005. <http://presscouncil-ks.org/ep-content/uploads/2018/11/Press-Code-for-Kosovo-eng.pdf>

89 Nga 28 anëtarë vetëm 3 janë gazeta klasike, të tjerët janë media online

90 Cohu. Media Monitori Online 2018-2019. Prishtinë. 2019. faqe 9. [http://www.cohu.org/repository/docs/22\\_-\\_Online\\_Media\\_Monitor\\_-\\_ALB\\_-\\_04\\_12591.pdf](http://www.cohu.org/repository/docs/22_-_Online_Media_Monitor_-_ALB_-_04_12591.pdf)

Forma më e zakonshme e presionit që ushtrojnë me-naxhmentet ndaj gazetarëve individualë është kër-kesa për rritjen e sasisë (normës) së shkrimeve di-tore/javore, gjë që është bërë shqetësim serioz për raportimin e tyre etik, pasi rritja e kuotave shoqë-rohet me një rritje të gjasave për raportim të keq/do-bët<sup>91</sup> pasi gazetarët nuk kanë kohë të mjaftueshme për të kryer hulumtime për informacione të sakta.<sup>92</sup> Kjo vlen veçanërisht për mediet në internet, ku presi-oni për lajme shpie në kopjimin e lajmeve dhe artiku-je ose në përdorimin e statuseve të medieve socia-le, të cilat shpesh janë burime të lajmeve të rreme.<sup>93</sup> Një formë tjetër e presionit ndaj gazetarëve është ed-he imponimi për mbulimin e ngjarjeve ose personave prej të cilëve kanë interes mediet ose pronarët e tyre. Këto presione shpesh vinë në formë të kërcënimeve me largim nga puna, nëse nuk i zbatojnë detyrat që u caktohen.<sup>94</sup>

Në vitin 2019, në mediet sociale ishte publikuar foto-ja e një gruaje të përkatësisë etnike rome, trans-gji-nore, e cila akuzohej publikisht se ishte trafikante e fëmijëve.<sup>95</sup> Kjo fotografi u publikua shumë shpejt në mediet, të cilat në vend se të vërtetonin akuzat pu-blike që ngriheshin ndaj saj e përhapën foton si dhe pretendimin e atyre që e kishin shpërndarë në plat-format e rrjeteve sociale. Kështu, nga një postim që përhapte një lajm të rremë, mediet publikuan laj-me me tituj bombastikë, si: “*ky person ka tmerru-ar prindërit në Kosovë: Po na i kidnapon fëmijët*”<sup>96</sup>; “*Burrë i veshur si një grua po i rrezikon fëmijët*”<sup>97</sup>;

“*Vëmendje: Ky burrë i veshur si grua po rrëmben fëmijë?*” e të ngjashëm<sup>98</sup>.

Pas shndërrimit të një postimi në “lajm”, gruaja në fo-tografi u sulmua dy herë brutalisht nga turmat e të rinjve, në Ferizaj dhe në Lipjan.<sup>99</sup> Pas sulmeve dhe verifikimit nga policia doli se dyshimet e ngritura në rrjetet sociale e të përhapura nga mediet kanë qenë të pabazuara dhe lajmi ishte i rremë, duke bërë që shumica e medieve i hoqën artikujt në të cilët rapor-tohej për “rrëmbyesin e fëmijëve” dhe lanë vetëm raportimet për sulmin ndaj gruas dhe deklaratat që dënonin sulmet ndaj saj.

AGK ka shprehur shqetësimin se mediet nuk i kanë respektuar dhe nuk i kanë zbatuar standardet etike dhe profesionale në këtë rast. Përmes një deklaratë publike, AGK u bëri thirrje të gjitha medieve dhe ga-zetarëve që t’iu përmbahen standardeve etike dhe profesionale të raportimit dhe të mos i nënshtrohen lakmisë për klikime.<sup>100</sup>

### B3 Pavarësia editoriale në Transmetuesin Publik

RTK-ja, e ka kodin e vet etik e profesional, “Standardet Profesionale dhe Parimet Etike të Programit të Gazetarisë së RTK”<sup>101</sup>, si dhe një Komision disiplinor që është përgjegjës për trajtimin e shqetësimeve eti-ke e profesionale. Por, ky kod zbatohet pjesërisht dhe në formë selektive vetëm ndaj punonjësve të caktu-ar. Sipas burimit anonim<sup>102</sup>, disa nga gazetarët dhe re-daktorët e këtij transmetuesi ndonëse kanë shfaqur anime politike përmes ekranit ose edhe rrjeteve so-ciale dhe janë përfshirë në mënyrë të drejtpërdrejtë në fushata parazgjedhore të subjekteve politike, ma-

91 Berisha, Arta, “Rruga e vështirë drejt transformimit të mediave në Kosovë”. *Observatori Evropian i Gazetarisë*, 24 gusht, 2018, parë më 05 janar 2020, <https://al.ejo-online.eu/profesionalizmi-ne-media/gazetaria-e-medias/rruga-e-veshtire-drejt-transformimit-te-mediave-ne-kosove>

92 BIRN, “Presion i pafund! Raportimi për krimin e organizuar në Kosovë”. Prishtinë. 2018. 2. <https://balkaninsight.com/en/content/uploads/2018/01/Kosovo-country-report-aib.pdf>

93 Berisha, Arta, “Kur mediat ringjallin plakun pas 17 viteve”. Zeri, 07 janar 2019, parë më 07 dhjetor, 2019, <https://zeri.info/zerat/233234/e-verteta-online-kur-mediat-laquo-ringjallin-raquo-plakun-pas-17-viteve/>

94 Fokus Grupi me gazetarët nga media e shtypur, transmetuese, OJQ dhe media online, i drejtuar nga Liron Kafexholli & Shkumbin Beqiri (11 dhjetor 2019).

95 Jonathan Lee, “DHUNA KUNDËR ROMËVE SHPËRTHEN NË KOSOVË”, Qendra Evropiane e të Drejtave të Romëve, 14 qershor 2019 <http://www.errc.org/he/es/anti-roma-violence-erupts-in-kosovo>

96 Kosova Sot, “ky person ka tmerruar prindërit në Kosovë: Po na i kidnapon fëmijët” 29 maj 2019 <https://www.kosova-sot.info/lajme/382958/ky-person-ka-tmerruar-prinderit-ne-kosove-po-na-i-kidnapon-femijet/?fbclid=IwAR107KcEuSoeSc0XatBQdkRpmleQOTmHHYfMQ4oAc6XZIDKkbtUbFUoovY>

97 Gota News, Vëmendje: Një burrë i veshur si grua po i kidnapon fëmijët?, 25 maj, 2019. <https://gotanews.tv/nje-burre-i-veshur-si-grua-te-irrezikuar-femijet-ne-kosove/?fbclid=IwAR3JasVZKqE8YByJa5y3X8r4QfGKhrG7feVgqxUuskUmVha2Fs-pvbrZbBg>

98 FMImages, Mediat online që ende nuk kanë hequr raportimet e tyre për gruan rome <https://www.fmimages.net/portalet-qe-ende-nuk-e-kane-larqar-lajmin-e-rrjeshem-per-gruan-rome/?fbclid=IwAR3t6rLISaR8BMDfVl5VSwcbQ5lWG7OZFaHWgBRTfG6kWJWHtgsW0wo7M>

99 [https://www.youtube.com/watch?v=A6glV3JFzXM&feature=youtu.be&fbclid=IwAR00\\_vE-1vtKxix3pwlcgf5b9KT0hI5R2Gs23PHTWg773IMHcX8edFbcSA](https://www.youtube.com/watch?v=A6glV3JFzXM&feature=youtu.be&fbclid=IwAR00_vE-1vtKxix3pwlcgf5b9KT0hI5R2Gs23PHTWg773IMHcX8edFbcSA)

100 Liridona Ademaj, “Sulmi ndaj gruas rome: AGK kërkon nga mediat tu përmbahen kritereve profesionale dhe etike të raportimit”, Kallxo, 31 maj 2019. <https://kallxo.com/shkurt/sulmi-ndaj-gruas-rome-agk-kerkon-nga-mediat-tu-permbahen-kritereve-profesionale-dhe-etikes-se-gazetarise/?fbclid=IwARVh-zuV17TLGP58qN9BfcPY-hEGiEbNCAZa7ZQ3h-1sx7deyvPZ3QFzfl>

101 Radio Television of Kosovo [RTK], Standardet profesionale dhe parimet etike të gazetarisë në programet e radiotelevizionit të Kosovës [Professional and ethical standards of the RTK journalists]. Prishtina. 2015. <http://www.rtklive.com/pages/files/standardet-profesionale.pdf>

102 Anonim 1, gazetar i RTK, Intervistë nga Liron Kafexholli, 10 shkurt 2020

dje edhe në zgjedhjet e fundit parlamentare, ndaj tyre nuk është marrë asnjë masë disiplinore përdërisa ka raste kur inician komisione disiplinore për gazetarë të caktuar që ngrisin zërin për shkeljet dhe padrejtësitë brenda institucionit. Sipas burimit tjetër anonim<sup>103</sup>, gazetarët janë përpjekur ta luftojnë këtë fenomen edhe nga brenda, por komisioni disiplinor është selektiv me rastin e vendimeve ndaj gazetarëve të caktuar, kështu që ndaj gazetarëve që e kanë shkelur hapur kodin etik e profesional nuk ka marrë asnjë masë.

Transmetuesi Publik ka vendosur edhe rregulla të brendshme organizative<sup>104</sup> që synojnë ta ruajnë pavarësinë e redaksive<sup>105</sup>. Megjithatë, varësia financiare nga qeveria ka çuar në ndërhyrje politike, kështu që RTK-ja shpesh kritikohet për anshmëri, keqmenaxhim, nepotizëm dhe për ndërhyrje politike. Komisioni Evropian e ka shprehur shqetësimin për mungesën e pavarësisë së RTK-së dhe ka rekomanduar sigurimin e burimeve tjera financiare për transmetuesin publik, kryesisht përmes parapagimit apo burimeve të tjera të pavarura.<sup>106</sup> Për më tepër, gazetarët e RTK-së kanë thënë se ky transmetues publik ngurrton të mbajë qëndrim kritik ndaj qeverisë.<sup>107</sup> Kohët e fundit, RTK-ja është cilësuar si medium që shmang mbulimin e ngjarjeve që kanë të bëjnë me krimin e organizuar, siç thuhet, për shkak të presionit të qeverisë ose grupeve të interesit.<sup>108</sup>

Presioni ndaj gazetarëve të RTK-së ushtrohet kryesisht përmes censurës. Format më të zakonshme janë kërkesat për censurimin e temave, favorizimi i ngjarjeve, temave, figurave politike apo personave me ndikim, relativizimi ose heshtja e ngjarjeve dhe temave që mund të cenojnë interesat e grupeve politike ose të grupeve të interesit, seleksionimi i të ftuarve në emisione, etj<sup>109</sup>. Stafi i RTK-së që është i lidhur me politikën evitojnë raportimin kritik ndaj politikës, duke penguar gazetarët që të raportojnë për

to.<sup>110</sup> Për më tepër, siç kanë treguar gazetarë të RTK-së, disa punëtorë të transmetuesit publik janë ngritur në detyrë jo për punën e tyre profesionale, por për përkatësinë e tyre politike.<sup>111</sup>

Në vitin 2019, nëntë gazetarë ngritën akuza ndaj punëdhënësit të tyre, Transmetuesit Publik, RTK, për ushtrim të censurës.<sup>112</sup> Ata u etiketuan menjëherë nga menaxhmenti si “gazetarë politik”. AGK, përmes një deklarate publike, e ka dënuar ashpër këtë akt dhe ka kërkuar nga stafit drejtues i RTK-së që të distancohet nga etiketimet të tilla.<sup>113</sup>

Është raportuar se ndërhyrjet politike në punën e gazetarëve të Transmetuesit Publik janë bërë edhe përmes seleksionimit të pyetjeve që u shtrohen figurave politike e publike, madje edhe përmes diktimit të pyetjeve që mund të parashtrohen.<sup>114</sup> Në vitin 2019, Nebih Maxhuni, gazetar i RTK-së e bëri publik komunikimin në rrjetet sociale me kryeredaktorin e tij Ridvan Berisha. Në këtë komunikim shkruhet se Berisha ia ka dërguar pyetjet që duhet t’ia parashtrojë gazetari Presidentit. U vërtetua se pyetjet që i kishte dërguar Berisha, ishin formuluar nga këshilltari i Presidentit. Madje, gazetari Maxhuni është kontaktuar nga këshilltarët për media të Presidentit, të cilët janë përpjekur ta bindin gazetarin që të mos i bëjë publike bisedat me kryeredaktorin e tij. Megjithatë, Maxhuni edhe këtë e ka bërë publike.

AGK ka reaguar përmes një deklarate duke e dënuar ndërhyrjen e Zyrës së Presidentit dhe ka kërkuar që të heq dorë nga përpjekjet për t’iu diktuar agjenda medie. AGK-ja ka shprehur shqetësimin edhe për gatishmërinë e profesionistëve që t’u nënshtrohen agjendave politike, qoftë vullnetarisht ose përmes formave të ndryshme të ndikimit, siç ka bërë kryeredaktori duke keqpërdorur pozitën e tij.<sup>115</sup> AGK-ja u ka bërë thirrje gazetarëve që të vazhdojnë ta ruajnë integritetin e tyre profesional, të raportojnë duke respektuar normat etike dhe të vazhdojnë t’i denoncojnë rastet të tilla të ushtrimit të ndikimit. Për

103 Anonim 3 gazetar i RTK, Intervistë nga Liron Kafexholl, 04 qershor 2020

104 RTK. Rregullore për organizimin e brendshëm të shërbimit publik të transmetimeve [Policy on the Internal Organization of the Public Broadcasting Service]. Prishtina, 2015. [http://www.rtklive.com/pages/files/regullore\\_organizim\\_brendshem.pdf](http://www.rtklive.com/pages/files/regullore_organizim_brendshem.pdf)

105 Anonim 3, gazetar i RTK-së, Intervista nga Liron Kafexholl, 04 qershor 2020

106 Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë. “BE në Kosovë është e shqetësuar për mungesën e transparencës në ndryshimin e Ligjit për RTK”, Prishtinë, 27 janar, 2017, parë më 1 shkurt 2020. [https://eeas.europa.eu/delegations/Kosovo/19399/node/19399\\_is](https://eeas.europa.eu/delegations/Kosovo/19399/node/19399_is)

107 Fokus Grupi me gazetarët nga media e shtypur, transmetuese, OJQ dhe media online, i drejtuar nga Liron Kafexholl & Shkumbin Beqiri (11 dhjetor 2019).

108 BIRN. “Presion i pafund! Raportimi për krimin e organizuar në Kosovë”. Prishtinë, 2018, 7. <https://balkaninsight.com/wp-content/uploads/2018/01/Kosovo-country-report-olb.pdf>

109 Anonim 3, gazetar i RTK, Intervista nga Liron Kafexholl, 04 qershor 2020

110 Freedom House. 2017. Freedom of the Press 2016. Washington, DC: Freedom House. <https://freedomhouse.org/report/freedom-press/2016/kosovo>

111 Anonim 3, gazetar i RTK, Intervista nga Liron Kafexholl 4 qershor 2020

112 Liridon Rama. “RTK under fire for irregularities”. 23 August, 2019. Prishtina. <https://kosovotopointzero.com/en/rtk-under-fire-for-irregularities/>

113 AJK. Management of RTK to distance itself from denigrating language towards its journalists. November 08, 2019. Prishtina. <http://agk-ks.org/agk-menaxhmenti-i-rtk-se-te-distancohet-nga-qjuha-denigruese-ndaj-gazetareve/>

114 Koha.net. Gazetari i RTK-së shpërfaq ndërhyrjet e stafit të Thaçit në televizionin publik. [RTK journalist exposes Thaci’s staff interventions on public television]. January 12, 2019. Prishtina. <https://www.koha.net/arberi/139250/gazetari-i-rtk-se-shperfaq-nderhyrjet-e-presidencës-thaci-ne-televizionin-publik/>

115 AGK. “AGK kundërshton ndërhyrjen e presidencës në RTK”. 12 janar 2019. <http://agk-ks.org/agk-kundershton-nderhyrjen-e-presidencës-ne-rtk/>

më tepër, AGK-ja ka kërkuar që menaxhmenti i RTK-së të mos heshtë, por ta adresojë çështjen në përputhje me rregulloret e brendshme dhe me standardet etike e profesionale, pasi rastet e tilla e dëmtojnë imazhin e transmetuesit publik dhe të komunitetit të gazetarëve.

Një shembull ilustrues i presionit të qeverisë mbi të gjitha redaksitë është rritja e stafit të RTK. Në Transmetuesin Publik janë punësuar punëtorë të rinj pa konkurse e pa kriteret e caktuara. Përkundër vështirësive financiare, RTK gradualisht e ka rritur numrin e punëtorëve. Nga 725 punëtorë me orar të plotë, sa kishte në muajin dhjetor të vitit 2016, numri i punëtorëve me orar të plotë ka arritur në 807, në muajin dhjetor të vitit 2018<sup>116</sup>.

#### **B4 Pavarësia editoriale në mediet e sektorit jofitimprurës**

Përceptimi i pjesëmarrësve në fokus grup ishte që, pavarësia editoriale e gazetarëve është më e madhe në sektorin e mediave jofitimprurëse, kryesisht për shkak të stabilitetit të tyre financiar. Sektori i mediave jofitimprurëse është i vogël në Kosovë dhe përfshinë: BIRN, Kosovo 2.0 dhe Çohu. Ato e kanë rregulloret e tyre për pavarësinë e tyre editoriale dhe sjelljen e gazetarëve. Me një stabilitet më të madh financiar që sigurohet përmes donatorëve dhe një mbikëqyrje më të madhe, ato kanë shkallë më të lartë të përgjegjësisë dhe transparencës. Për më tepër, pozita e tyre i bënë ato janë më të pavarura nga reklamata.<sup>117</sup>

Gjatë vitit 2019, nuk ka pasur raportime për raste të presioneve mbi mediet jofitimprurëse dhe nuk ka shembuj ilustrues për ushtrim të presionit ndaj medieve jofitimprurëse.<sup>118</sup>

#### **B5 Liria e gazetarëve në procesin e prodhimit të lajmeve**

Shkalla e lirisë që e kanë gazetarët në përzgjedhjen e storjeve është e kufizuar. Ndonëse kanë raportuar se përgjithësisht janë të lirë për të trajtuar ndonjë storje, ata monitorohen për mënyrën si i qasen dhe për këndvështrimin e tyre ndaj storjes.<sup>119</sup> Kjo vlen posaçërisht kur bëhet fjalë për storje që prekin persona dhe/ose organizata me ndikim në medie.<sup>120</sup> Ky kufizim, megjithatë, manifestohet kryesisht në formë të vetcensurës.<sup>121</sup>

Gazetarët marrin pjesë në procesin e planifikimit të temave në redaksitë e të gjitha medieve, pasi janë vetë gazetarët ata që propozojnë ose sugjerojnë tema për të cilat kanë informacion ose duan t'i ndjekin. Sidoqoftë, redaktorët e medieve më të mëdha, mbajnë më rrallë takime analizuese të lajmeve dhe temave, në krahasim me mediet më të vogla që mbajnë takime më të rregullta, kryesisht ditore.<sup>122</sup>

Gazetarët e perceptojnë rolin e tyre kryesisht si vëzhgues pasivë dhe jo si monitorues dhe mendojnë që nuk kanë ndikim të madh në shoqëri.<sup>123</sup> Kjo ndodh kryesisht për shkak të kuotave të prodhimeve që kërkohen prej tyre, gjë që u lë atyre pak kohë për të kryer hulumtime të duhura për ta mbuluar në mënyrën e duhur një temë a një çështje, gjë që do të bënte që gazetarët të kenë rol më të madh në trajtimin e ngjarjeve, temave apo çështjeve me interes publik. Gazetarët nuk janë të kënaqur me këtë qasje, por mendojnë se nuk është në fuqinë e tyre të bëjnë ndonjë ndryshim për sa kohë kushtet e tyre të punës nuk përmirësohen përmes ndonjë ndryshimi në legjislacionin në fuqi.<sup>124</sup> Kjo nuk vlen për gazetarët e BIRN-it, të cilët mendojnë se kanë ndikim më të madh të qytetarët.<sup>125</sup>

116 RTK. Raporti vjetor 2018. 2018. faqe 23. [https://www.rtklive.com/sq/pages/files/raporti\\_vjetor\\_2018\\_AL\\_pdf?fbclid=IwAR2sF1JFSMUPlf9\\_jgQtY6MoJb-7EdHct3FDUG\\_zpMfDt6T-7zqQQ-zsIEI](https://www.rtklive.com/sq/pages/files/raporti_vjetor_2018_AL_pdf?fbclid=IwAR2sF1JFSMUPlf9_jgQtY6MoJb-7EdHct3FDUG_zpMfDt6T-7zqQQ-zsIEI)

117 Fokus Grupi me gazetarët nga media e shtypur, transmetuese, OJQ dhe media online, i drejtuar nga Liron Kafexholli & Shkumbin Beqiri (11 dhjetor 2019).

118 Visar Prebeza, BIRN Redaktor, e-mail për Liron Kafexholli, 20 shkurt 2020

119 3 fokus grupe me gazetarë nga media e shtypur, transmetuese, OJQ dhe media online, realizuar nga Liron Kafexholli & Shkumbin Beqiri (11, 13, 26 dhjetor 2019).

120 Anonim 3, gazetar RTK, Intervistë nga Liron Kafexholli, 4 qershor 2020

121 TASCQ. Raporti i Semaforit 2017 Kosova\* Raporti i Monitorimit të 'Udhëzimeve të BE-së për Lirinë e Medias dhe Integritetin e Mediave 2014-2020' për 2017. faqe 6, parë më 3 janar 2020. [https://ec.europa.eu/neighborhood-enlargement/sites/near/files/media\\_traffic\\_lights\\_report\\_kosovo.pdf](https://ec.europa.eu/neighborhood-enlargement/sites/near/files/media_traffic_lights_report_kosovo.pdf)

122 3 fokus grupe me gazetarë nga media e shtypur, transmetuese, OJQ dhe media online, realizuar nga Liron Kafexholli & Shkumbin Beqiri (11, 13, 26 dhjetor 2019).

123 3 fokus grupe me gazetarë nga media e shtypur, transmetuese, OJQ dhe media online, realizuar nga Liron Kafexholli & Shkumbin Beqiri (11, 13, 26 dhjetor 2019).

124 Ibid.

125 Fokus grup me gazetarë nga media e shtypur, transmetuese, OJQ dhe media online, realizuar nga Liron Kafexholli & Shkumbin Beqiri (26 dhjetor 2019)

Gazetarët janë të ndjeshëm ndaj ndikimit të redaktorëve dhe të menaxherëve të medieeve ku punojnë, si dhe ndaj ndikimit të aktorëve politikë, të cilët e ushtrojnë atë në mënyrë të tërthortë, përmes menaxherëve të medieeve. Gazetarët mendojnë se shkalla e profesionalizmit në punë është e ulët, pikërisht për shkak të ndikimit që ushtrohet mbi ta, gjë që i bën të ndjehen të pafuqishëm.<sup>126</sup>

Të gjithë gazetarët e paraqitën vetcensurën si problemin më të zakonshëm të punës së tyre. Ata kanë pranuar se në fazat e hershme të karrierës së tyre mësojnë se çfarë dhe si duhet të raportojnë. Frika se mund ta humbin vendin e punës është arsyeja kryesore që gazetarët t'i nënshtrohen vetcensurës. Gazetarët në një fokus grup pranuan se mes vete bisedojnë shpesh për problemet me të cilat përballen dhe për shkallën e lartë të vetcensurës, por se nuk kanë kurajo që për këtë të diskutojnë me menaxhmentin. Gazetarë më me përvojë në medium e dinë se cilët janë kufijtë e lirisë së tyre gjatë trajtimit të një teme të caktuar dhe thjeshtë, nuk i kalojnë këta kufij. Gazetarët e rinj duhet që të mësojnë kufijtë e lirisë së tyre shpejt, përndryshe rrezikojnë ta humbin punën.<sup>127</sup>

## B6 Pozita e gazetareve

Në përgjithësi, kushtet e punës për gazetaret gra nuk janë perceptuar ndryshe nga kushtet e punës të gazetarëve. Atyre u ngarkohen punë të njëjta me kolegët e tyre burra. Por, përveç kësaj, gazetaret thonë se pabarazia gjinore është fenomen i njohur në të gjitha mediet. Sipas tyre "ka tendencë që burrat të jenë menaxherë në mediet elektronike" ndërsa "gratë punojnë në ndërrimet e pasditës", "ka pak gra redaktore" dhe "shtatzënia shpesh mund të çojë në ndërprerje të kontratave të punës, etj"<sup>128</sup>. Të dhënat e gjetura mbi kontrata të gazetarëve nuk janë të ndara sipas gjinore.<sup>129</sup>

Ekziston një shpërpjesëtim statistikor i madh në strukturën gjinore nëpër redaksi. Një studim i kryer nga KPM-ja në 7 transmetuesit e vendit, publik dhe privatë, ka gjetur se gratë janë dukshëm më pak të angazhuara në procesin e redaktimit. Ato përbëjnë vetëm 25.8% të stafit redaktues të lajmeve.<sup>130</sup>

Gazetarët nuk kanë dashur të flasin për rrogat e tyre, megjithatë kanë deklaruar se pagat e grave janë përgjithësisht më të ulëta se ato të meshkujve, megjithëse nuk kanë përmendur shifra.

Presionet në bazë gjinore janë rritur në rastet kur gazetaret janë shtatzëna, gjë që ka pasur implikime edhe në kontratat e tyre dhe në ngarkesën e tyre në punë. Kontratat e grave, herë pas here, shkurtohen në kontrata gjashtë mujorshë, pasi ato të kthehen nga pushimi i lehonisë. Presioni i vazhdueshëm ndaj gazetareve shpesh bëhet me qëllim që ato të detyrohen të heqin dorë nga puna. Format më të zakonshme të presionit ndaj gazetareve janë shtimi i numrit të temave që u kërkohet t'i realizojnë, ndërrimi i fushave dhe sektorëve që i përcjellin, etj.<sup>131</sup>

126 3 fokus grupe me gazetarë nga media e shtypur, transmetuese, OJQ dhe media online, realizuar nga Liron Kafexholli & Shkumbin Beqiri (11, 13, 26 dhjetor 2019).

127 Ibid

128 Fokus grup me gazetarë femra nga media e shtypur, transmetuese, OJQ dhe media online, realizuar nga Liron Kafexholli & Shkumbin Beqiri 13 dhjetor, 2019.

129 TASCQ. Raporti i semaforit 2017 Kosova\* Raporti i Monitorimit të 'Udhëzimeve të BE-së për Lirinë e Medias dhe Integritetin e Mediave 2014-2020' për 2017. faqe 9. parë më 3 janar 2020. [https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/media\\_traffic\\_lights\\_report\\_Kosovo.pdf](https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/media_traffic_lights_report_Kosovo.pdf)

130 Komisioni i Pavarur për Media [KPM]. Monitorimi i mbulimit të lajmeve të Ofruesve të Shërbimit Media-Vizuale. Prishtinë, 2019. faqe 46. <https://www.kpm-ks.org/assets/cms/uploads/files/Raport%20monitorimi%20e%20lajmeveqendrore%20t%C3%AB%20OSHMA-ve%2C%20periudha%20prill-maj%202019.pdf>

131 3 fokus grupe me gazetarë nga media e shtypur, transmetuese, OJQ dhe media online, realizuar nga Liron Kafexholli & Shkumbin Beqiri (11, 13, 26 dhjetor 2019).



## Siguria e gazetarëve

Gjatë vitit 2019 janë raportuar 21 raste të sulmeve dhe kërcënimeve ndaj gazetarëve dhe ndaj medieve. Shumica prej këtyre rasteve kanë qenë kërcënime dhe sulme ndaj gazetarëve. Kur krahasohet ky numër i sulmeve dhe kërcënimeve me atë të viteve të mëparshme, shihet se ka pasur rritje të rasteve të sulmeve ndaj gazetarëve gjatë vitit 2019 (në vitin 2017 janë raportuar 24 raste, ndërsa në vitin 2018 janë raportuar 17 raste). Rritja e numrit të rasteve të sulmeve ndaj gazetarëve është shumë shqetësuese, por shtimi i gatishmërisë së gazetarëve për t'i raportuar këto rastet është ndryshim inkurajues i gatishmërisë së tyre për të ndjekur sulmuesit e tyre.



Kategoritë	Frekuenca	Përshkrimi
Kërcënime me jetë dhe me lëndime trupore	5	Kërcënimet verbale ose me shkrim me dëmtim trupor, përfshirë vdekjen, drejtuar në mënyrë të drejtpërdrejtë, përmes palëve të treta, për komunikimeve elektronike ose fizike. Ato mund të jenë referenca të tërthorta ose të qarta dhe përfshijnë kërcënime për vrasjen e të afërmeve, të kolegëve ose të burimeve të gazetarit.
Kërcënime të tjera ndaj gazetarëve Presione institucionale ose administrative	8	Kërcënimet që përfshijnë vëzhgimin ose ndjekjen, thirrjet telefonike ngacmuese, kërcënimet me vendime gjyqësore ose masa administrative, deklaratat agresive nga zyrtarët publikë ose forma të tjera të presionit që mund të rrezikojnë sigurinë e gazetarëve në punën e tyre.
Kërcënime ndaj medieve dhe organizatave	1	Kërcënimet verbale ndaj pronës ose personelit të medieve dhe organizatave, të adresuara drejtpërdrejt, përmes palëve të treta, përmes mjeteve elektronike ose në mënyrë fizike. Ato mund të jenë referenca të nënkupteshme ose të qarta dhe përfshijnë referenca për media specifike ose për personelin e saj.
Sulme faktike ndaj gazetarëve	7	Sulmet faktike mund të përfshijnë dëmtime fizike ose mendore, rrëmbim, hyrje në shtëpi/zyrë, sekuestrim të pajisjeve, ndalim arbitrar, tentin atentate, etj.
Vrasje të gazetarëve	0	Vrasjet mund të përfshijnë vrasjet në shkëmbim zjarri, vrasje me shpërthim bombe, vrasje duke e rrahur për vdekje.
Sulme ndaj medieve dhe organizatave	0	Sulmet faktike ndaj pasurive të medieve e të organizatave, ndaj personelit të tyre, me sekuestrim të pajisjeve, me deklarata agresive të zyrtarëve publikë, etj.

Gjatë vitit 2019 janë raportuar gjithsej 5 raste kërcënime jetë dhe me gjymtim të gazetarëve. Kërcënimet kanë qenë nga më të ndryshme, prej thirrjeve publike, si ajo e një gazetari nga Maqedonia që bëri thirrje për vrasjen e gazetarëve të portalit online “Periskopi” dhe të portalit “IndeksOnline” e deri te kërcënimet direkte, si në rastin e anëtarit të familjes së një imami, i cili e kërcënoi një gazetar të Televizionit Klan Kosova duke thënë se, ose ai ose gazetari do të jenë mbi tokë nëse publikohet ndonjë pamje e kronikës. Në mesin e rasteve të raportuara është edhe ai i drejtorit për kulturë në Komunën e Skenderajt i cili e kërcënoi gazetarin e gazetës “Zëri” për një artikull ku kritikohet komuna. Të gjitha rastet janë raportuar në Policinë e Kosovës, përveç rastit të imamit, pasi gazetari nuk deshë ta raportonte në polici, në mënyrë që të mos përshkallëzohet më shumë situata.<sup>132</sup>

Në vitin 2019 janë raportuar shtatë raste të tjera kërcënimi ndaj gazetarëve. Në katër prej këtyre rasteve kanë qenë të përfshirë zyrtarë publik ose politikanë, në dy raste kërcënimet kanë ardhur nga partia politike Vetëvendosje, e cila i ka akuzuar gazetarët dhe redaktorët e njëjës prej medieve se përmes raportimit të dobët e kanë ndihmuar vdekjen e një aktivisti të saj. Njëri prej rasteve shumë shqetësuese ishte edhe rasti i kërcënimit në të cilin u përfshi edhe ish Avokati i Popullit, Sami Kurteshi. Një rast tjetër shqetësues ishte ai i Kryetarit të Kuvendit, i cili i dërgoi mesazh me WhatsApp redaktorit dhe shefit të T7, duke përdorur gjuhë të qartë kërcënuese. Gjatë vitit 2019, një deputet i Kuvendit të Kosovës ka bërë kallëzim penal kundër një gazetari për nxitje të urrejtjes etnike. AGK është duke e monitoruar procesin në Prokurori. Në të tria rastet tjera gazetarët janë kërcënuar nga persona civilë. Njëri ndër ta

ka qenë kërcënim i një gazetari nga një përfaqësues i Bashkësisë Islame të Kosovës, të cilit nuk i kishte pëlqyer një artikull për të.<sup>133</sup>

Gjatë vitit 2019 është raportuar edhe një kërcënim ndaj organizatave të medieve. Në llogarinë zyrtare të Partisë Demokratike të Kosovës (PDK) në rrjetet sociale është publikuar një thirrje publike drejtuar qytetarëve të Kosovës që të mos i besojnë “Gazetës Express”, me arsyetim se ajo ka “një agjendë” kundër kësaj partie.<sup>134</sup>

Vitin e kaluar, AGK-ja i ka regjistruar 7 raste të sulmeve fizike ndaj gazetarëve. Dy nga këto sulme kanë ndodhur derisa një gazetar po përpiqej të raportonte nga një shesh ndërtimi, ndërsa një sulm është kryer ndaj një gazetari që po përpiqej të raportonte për një kazino. Katër rastet tjera të kërcënimeve faktike ndaj gazetarëve janë brë nga zyrtarë shtetërorë. Një gazetarë që po tentonte të intervistonte një të burgosur është penguar ta bënte punën e saj nga rojet, ndërsa në një rast tjetër vetura e gazetarëve është dëmtuar gjatë një operacioni policor për lirim të një rruge të bllokuar. Në muajin qershor, një gazetar u sulmua fizikisht dhe iu morën pajisjet derisa po mbahej kuvendi zgjedhor i partisë politike, Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK). Në dhjetor të vitit 2019, në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës, një gazetar u sulmua fizikisht nga ministri i atëhershëm i Tregtisë dhe Industrisë. Sulmi ndodhi në praninë e policisë, e cila nuk ndërmoi asnjë veprim. Policët që ndodhen në vendin e ngjarjes u pezulluan nga puna më vonë për këtë shkas.<sup>135</sup>

<sup>132</sup> Databaza e AGK-së, <http://agk-ks.org/rastet/>

<sup>133</sup> Ibid.  
<sup>134</sup> Ibid.  
<sup>135</sup> Ibid.

## C1 Sjellja e institucioneve shtetërore dhe e aktorëve politikë në lidhje me mbrojtjen e gazetarëve

Nuk ka politika specifike të hartuara nga institucionet shtetërore që mbështesin mbrojtjen e gazetarëve, megjithatë Kushtetuta dhe ligjet tjera të zbatueshme, përfshirë Kodin Penal, e rregullojnë çështjen e sigurisë së gazetarëve. Në vitin 2019, AGK-ja e ka nënshkruar një memorandum mirëkuptimi me Odën e Avokatëve të Kosovës, përmes së cilit sigurohet ndihmë juridike falas për gazetarët anëtarë. Zbatimi i këtij memorandumi monitorohet nga stafi i AGK-së. Dy gazetarë tashmë kanë përfitur nga kjo marrëveshje, pasi që i'u është dhënë ndihmë juridike falas.

Nuk ka mekanizma specifik në lidhje me sigurinë e gazetarëve, por Prokuroria dhe Gjykata Themelore e Prishtinës kanë caktuar koordinatore për mbledhjen e të dhënave për rastet e gazetarëve.<sup>136</sup> Megjithatë, ato janë të shpërdara dhe nuk janë publikuar si të sistemuara. Aktualisht sistemi gjyqësor po kalon nëpër një fazë të tranzicionit, përmes zhvillimit të SMIL, i cili do të konsolidojë të dhënat dhe do të mundësojë përcjelljen e lëndëve gjyqësore. Në përgjithësi, rastet e gazetarëve raportohen në Polici dhe Prokuroria ndërmerr masat e nevojshme hetimore, kurse AGK-ja monitoron, evokon dhe mbron interesat e gazetarëve. Megjithatë, mbetet e paqartë nëse SMIL do të konsolidojë edhe të dhënat e policisë.

Sulmet ndaj sigurisë së gazetarëve nga institucionet e shtetërore konsiderohen shkelje të lirisë së shprehjes, shkelje të të drejtave të njeriut dhe si vepra penale të sanksionuara me Kodin Penal, por zyrtarët publikë nuk pranojnë të bëjnë deklaratat, përveç në rastet e sulmeve fizike ndaj gazetarëve.

Nuk ka dokumente të miratuara nga institucionet shtetërore që ofrojnë udhëzime dhe ndalojnë ngacmimet, frikësimet ose sulmet fizike ndaj gazetarëve.<sup>137</sup>

Gjykata Themelore dhe Këshilli Prokurorial po e rrisin bashkëpunimin me AGK-në, e cila i përcjell sulmet dhe kërcënimet ndaj gazetarëve, megjithatë bashkëpunimi është ende i ngadalshëm dhe do të duhet të rritet për ta shkurtuar kohën e vendimeve lidhur me rastet. Në përgjithësi, institucionet shtetërore janë të përmbajtura dhe/apo nuk i miratojnë dhe nuk i promovojnë kërcënimet ndaj gazetarëve.

Një urdhër gjyqësor është i nevojshëm për të justifikuar mbikëqyrjen elektronike dhe urdhri për mbikëqyrje duhet të lëshohet vetëm në raste specifike të kërcënimit të lartë. Nuk ka të dhëna për rastet e mbikëqyrjes elektronike të gazetarëve.

## C2 Qasja e kodit penal dhe civil të drejtësisë ndaj kërcënimeve dhe akteve të dhunës ndaj gazetarëve

Në sistemin e drejtësisë në Kosovë nuk ka institucione/njësi specifike të dedikuara për hetime, ndjekje penale, mbrojtje dhe kompensim për sa i përket ofrimit të sigurisë së gazetarëve dhe çështjes së mosndëshkimit<sup>138</sup>.

Aktualisht nuk ka procedura të veçanta që adresojnë të gjitha format e dhunës ndaj grave, përfshirë dhunën ndaj grave gazetarësh<sup>139</sup>.

Agjencitë shtetërore nuk ofrojnë burime adekuata për të mbuluar hetimet, kurse masat e mbrojtjes për gazetarët janë joadekuata.

Ka masa të mbrojtjes të parapara për gazetarë që ata mund t'i kërkojnë nga policia. Pas raportimit të kërcënimeve ndaj gazetarëve, policia bën një vlerësim të kërcënimit dhe cakton një urdhër specifik mbrojtjeje, siç është patrullimi i policisë rreth vendit ku jeton dhe punon gazetari. Megjithatë, disa gazetarë kanë raportuar se kërcënimet ndaj tyre nuk merren seriozisht nga policia, siç ishte rasti i një gazetari që merrte kërcënime me vdekje nga një islamist radikal. Policia e pajisi gazetarin e kërcënuar vetëm me një jelek antiplumb, i cili ishte i padobishëm dhe jopraktik. Në vitin 2019 ka pasur një rast që gazetari ka kërkuar nga policia masë sigurie, por policia e ka aprovuar kërkesën e gazetarit për masa të sigurisë vetëm pas vlerësimit të kërcënimit dhe i ka ofruar mbrojtje fizike gazetarit<sup>140</sup>.

Kohëzgjatja e lëndëve lidhur me sigurinë e gazetarëve (siç shihet në Kutinë C1.1) tregon se hetimet e krimeve kundër gazetarëve, përfshirë frikësimet dhe kërcënimet, nuk hetohen shpejt dhe në mënyrë efektive. Megjithatë, rastet që marrin vëmendje të madhe në media kanë tendencë të trajtohen më seriozisht dhe të hetohen më shpejt, siç është rasti i sulmit fizik nga asoko-

<sup>138</sup> Ibid.

<sup>139</sup> Këshilli i Evropës, Hartimi i shërbimeve mbështetëse për viktimat e dhunës ndaj grave në Kosovë\*, 2017, parë më 12.12.2019: <https://rm.coe.int/seminar-pristina-report-eng/16807316df?fbclid=IwAR2aHz2CqNaCkl6lio7XfJlp3dAjlU44pG4Uq4jDqD5CLiQOVelhg4rfdw>

<sup>140</sup> Baki Kelani, Zyra për Informim Policia e Kosovës, 30 janar 2020

<sup>136</sup> 1) Koordinatorin në zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit për Rastet e Gazetarëve, dhe, 2) Koordinatorin në Gjykatën Themelore të Prishtinës për të mbledhur të dhëna për rastet e gazetarëve

<sup>137</sup> Flutura Kusari, intervista nga Liron Kafexhalli, 25 janar 2020.

he ministri i Tregtisë dhe Industrisë. Lidhur me këtë rast, u ndërmorën veprime të shpejta dhe policët në vendin e ngjarjes që nuk reagojnë ndaj sulmit u pezulluan nga puna. Megjithatë, çështja e sulmit është ende në procedurë<sup>141</sup>.

Nuk ka pasur ndjekje penale ndaj zingjirit të aktorëve të përfshirë në akte të dhunës apo të kanosjes së gazetarëve. Deri më tani nuk është identifikuar asnjë rast që në sulmet ndaj gazetarëve të jenë përfshirë më shumë se një autor, gjë që ngre dyshimet për cilësinë e hetimeve.

Trajnime të policisë, prokurorëve, avokatëve dhe gjyqtarëve që trajtojnë çështjet që kanë të bëjnë me sigurinë e gazetarëve ofrohen kryesisht nga sektori jofitimprurës. Në vitin 2019, për policinë janë organizuar katër trajnime për aspekte të ndryshme që kanë të bëjnë me mediet, duke filluar nga hetimet në mediet online e deri te rrjetet sociale dhe risitë në fushën e teknologjisë.<sup>142</sup> Ndërkaq, për punonjës të sistemit Gjyqësor dhe Prokurorial në vitin 2019 janë organizuar pesë trajnime. Më të rëndësishmet prej tyre ishin trajnime për nën 10 të Konventës Evropiane dhe trajnime për shpifje.<sup>143</sup>

---

<sup>141</sup> Xhorshina Bami, "Ministri i akuzuar për sulm ndaj gazetarit", *Prishtina Insight*, 19.12.2019, parë më 14 janar 2020: <https://prishtinainsight.com/minister-accused-of-assaulting-journalist/?fbclid=IeAR3lQEYfSDVZ2i5CC5UhlJY>"\_upsPI7Mr-Som2mBpyHEd19zoiz2v0ei7KIE

---

<sup>142</sup> Baki Kelani, *Zyra për Informim Policia e Kosovës*, 30 janar 2020

<sup>143</sup> Akademia e Drejtësisë, *Mbledhur nga buletinet e Akademisë së Drejtësisë*, 2019. <https://ad.rks-qov.net/sq/buletini>

**Pasqyra e aktiviteteve të përfunduara për zgjidhjen e disa prej sulmeve më serioze ndaj gazetarëve në pesë vitet e fundit**

2015	2016	2017	2018	2019
				18 Dhjetor 2019 – Prokuroria Themelore hapi hetimin e rastit. 10 Shkurt 2020- Sulmuesi është paditur për sulm nga Gjykta Themelore në Prishtinë
				8 Tetor 2019 – Gjykata Themelore në Prishtinë ka dënuar shkelësin me gjobë 200 euro.
		13 Nëntor 2017 – Gjykata Themelore e Gjilanit vendosi urdhër mbrojtës ndaj M.N. për kërcënimin e gazetarit.		
		17 Gusht 2017 – Policia filloi hetimin në vendin e krimit, duke mos pasur të dyshuar. (Përpjekjet për të përditësuar rastin ishin të pasuksesshme, pasi që Prokuroria Themelore nuk dha të dhëna pa pëlqimin e viktimës. Viktima e sulmit nuk kishte dëshirë të jap informata rreth procedurës së rastit).		
		13 Nëntor 2017- Policia hetoi vendin e ngjarjes dhe arrestoi të dyshuarin kryesor. (Përpjekjet për të përditësuar rastin ishin të pasuksesshme, pasi që Prokuroria Themelore nuk dha të dhëna pa pëlqimin e viktimës. Viktima e sulmit nuk kishte dëshirë të jap informata rreth procedurës së rastit).		
				03 Prill 2019 -Raportohet rasti në polici dhe policia fillon hetimin. Ndërkohë gazetari vendos të mos vazhdojë me padi në mënyrë që të eskaloj situata.

Ky hulumtim kishte për qëllim krijimin e peizazhit të medieeve nga këndvështrimi i lirisë dhe sigurisë së gazetarëve në Kosovë dhe pasqyrimin e kontekstit socio-ekonomik dhe politik për sigurimin e një mjedisi të favorshëm për zhvillim të qëndrueshëm të sektorit të medieeve. Raporti përfshinë çështjet dhe gjendjen gjatë vitit 2019 dhe vihet në krahasim me raportet e mëparshme lidhur me këtë temë.

## A Mbrojtja ligjore

Të gjeturat tregojnë se është bërë një përparim, pasi korniza legjislative konsiderohet mjaft gjithëpërfshirëse dhe është e strukturuar për të mbështetur zhvillimin e sektorit të medieeve dhe të gazetarëve. Ka përputhshmëri me rregulloret për zhvillimin e legjislativonit, i cili në vitin 2019 pati një përmirësim për sa i përket përfshirjes së palëve të interesuara, veçanërisht në krahasim me vitet e mëparshme të raportimit. Megjithatë, hulumtimi gjeti se megjithatë ka ende sfida në procesin e zbatimit.

Organi rregullator i medieeve audio-vizive, KPM-ja, dhe organi vetërregullues i shtypit të shkruar, KMSHK-ja, vlerësohen se funksionojnë përgjithësisht në mënyrë efektive, por ushtrimi i mandatit të tyre sfidohet për shkak të mungesës së burimeve adekuate. KMSHK-ja, ndonëse qëndron më mirë në trajtimin e ankesave, duhet të mbulojë edhe aspekte të tjera që kanë të bëjnë me mediet, siç janë çështja e pronarëve dhe pronësisë së medieeve online, të cilat janë probleme thelbësore dhe ndikojnë në transparencën dhe përgjegjshmërinë e medias në përgjithësi.

Sa i përket KPM-së, janë ngritur shqetësime lidhur me thjeshtësinë e procesit të licencimit të transmetuesve dhe ofertuesve të përmbajtjeve audio-vizive, si edhe procesi i përzgjedhjes së anëtarëve të bordit drejtues të tij, i cili e bën atë më të prirur për ndikime politike. Legjislacioni për pluralizmin politik dhe mbulimin e aktiviteteve të subjekteve politike gjatë periudhës jozgjedhore ka ende mangësi. Pavarësisht kësaj zbrazëtie, transmetuesit e licencuar duhet t'i përmbahen kodit të sjelljes të miratuar nga KPM-ja. Një numër i transmetuesve nuk i përmbahen gjithmonë këtij kodi, i cili megjithatë nuk i përfshin të gjitha mediet. Përsëri, mungesa e burimeve adekuate e bën KPM-në të paaftë për të kryer hetime për shkeljet e kodit. Boshllëku që lë legjislacioni duhet të rishikohet në mënyrë që ai të mbulojë siç duhet edhe periudhën jo zgjedhore. KPM-ja duhet të shtojë përpjekjet e saj në rregullimin e çështjeve të medias dhe të plotësojë statutin e vet në mënyrë që të përfshijë edhe aspekte më të gjëra lidhur me punën dhe veprimtarinë e medias.

Mbrojtja ligjore në lidhje me burimet e gazetarëve është e fortë dhe gazetarët ndihen të sigurt të realizojnë të drejtën e tyre për të ruajtur marrëdhënien me burimet e tyre. Por, shqetësimi ka të bëjë më shumë me zbatimin e dobët të Ligjit për Qasje në Dokumente Publike, konkretisht të dispozitave lidhur me trajtimin e kërkesave të gazetarëve nga institucionet publike. Mungesa e udhëzimeve të qarta lë hapësirë për interpretime të ndryshme. Mekanizmat e grumbullimit të të dhënave për monitorimin dhe referimin e lëndëve lidhur me shpifjen nuk sigurojnë efektivitet në trajtimin e lëndëve në institucionet gjyqësore. Besohet se përmes SMIL (Sistemi për Menaxhim Informativ të Lëndëve) që është duke u zhvilluar në sistemin gjyqësor do të mundësohet ndarja e lendeve dhe përcjellja në mënyrë sistematike.

Gazetarëve u garantohet e drejta dhe liria e asociimit në organizata sindikale. Ata përfaqësohen nga dy asociacione, AGK-ja dhe AGSK-ja. Aktualisht, në mediet e Kosovës, ekzistojnë vetëm tri organizata sindikale, të tria brenda Transmetuesit Publik, RTK. Por, këto sindikata ballafaqohen me ndërhyrje dhe forma të ndryshme të presionit të menaxhmentit. Ndërkaq, në mediet private nuk ekziston asnjë organizatë sindikale. Punëtorët e tyre nuk kanë bërë ndonjë organizim sindikal për shkak të pasigurisë ekonomike, frikës se mund t'i humbin vendet e tyre të punës, etj. Mungesa e një organizate sindikale që do të mbronte të drejtat e gazetarëve dhe që do t'i përfaqësonte interesat e të gjithë gazetarëve të Kosovës, ka bërë që AGK-ja të bëhet organi kryesor për mbrojtjen e gazetarëve.

## **B Pozita e gazetarëve në redaksi**

Ekkziston një pajtim që gjendja jo e mirë ekonomike e gazetarëve, si: mungesa e kontratave të punës ose kontratat afatshkurtra, pagat e ulëta dhe pagesat jo të rregullta, kushtet jo të mira të punës dhe përdorimi i tyre për të ushtruar presion tek gazetarët. Gjithashtu pabarazia gjinore rritë kushtet e vështira të punës për gratë gazetare, pasi që shtatëzania ndikon në kontratat e punës dhe gratë janë shumë më pak të përfaqësuara në dhomën editoriale. Këto kushte të punës kanë lënë gazetarët në një pozitë të brishtë ndaj ndikimeve dhe presioneve nga politika, pronarët medial dhe menaxhmenti, të cilët shihen si faktorët kryesorë në komprometimin e pavarësisht editoriale dhe raportimin etik të tyre. Presioni me kuotat ditore i detyron gazetarët që të raportojnë pa i verifikuar të gjithë komponentët e temës apo ngjarjes për të cilën raportojnë, kështu që rrezikojnë të japin informacione jo të plota ose të paqëndrueshme. Mbi të gjitha, pozita e tyre materiale dhe frika se mund të mbeten pa punë i shtyjnë gazetarët të bëjnë vetë-censurë dhe të mos raportojnë në mënyrë të pavarur e objektive.

Pajtueshmëria me kodin e sjelljeve është ndikuar shumë nga këto presione. Në rastin e transmetuesit publik, ka bërë që varësia financiare nga qeveria të çojë në ndërhyrje politike, ndërsa në rastin e medieve private, varësia nga sponsorët e tyre. Në gjendje më të mirë janë mediet e sektorit jofitimprurës, të cilat kanë më shumë pavarësi financiare, prandaj ato bien më pak pre e presioneve dhe ndikimeve. Pavarësia editoriale cenohet kryesisht nga vetcensura. Gazetarët kanë raportuar se janë të lirë të zgjedhin vetë storjet, por janë të kufizuar në trajtimin e tyre në mënyrë të plotë, të paanshme dhe objektive.

## C Siguria e gazetarëve

Në vitin 2019 në Kosovë ka pasur rritje të numrit të rasteve të kërcënimeve dhe të sulmeve ndaj gazetarëve. Gjatë këtij viti janë raportuar 21 raste. Shpresëdhënëse konsiderohet rritja e gatishmërisë së gazetarëve për raportimin e rasteve të sulmeve e kërcënimeve ndaj tyre, gjë që konsiderohet si rritje e sigurisë së gazetarëve për t'i raportuar ato.

Ndërsa numri i sulmeve të raportuara është rritur, hulumtimi zbuloi se institucionet shtetërore dhe aktorët politikë nuk kanë burime të mjaftueshme për adresimin e çështjes së sigurisë së gazetarëve, ndërsa sistemi gjyqësor është shumë i ngadalshëm në zgjidhjen e lëndëve që kanë të bëjnë me sulme dhe kërcënime të gazetarëve. Prokuroria dhe Gjykata Themelore në Prishtinë bënë përpjekje për rritjen e efikasitetit në trajtimin e këtyre lëndëve, duke caktuar koordinatore për grumbullimin e të dhënave lidhur me rastet e gazetarëve, ndërsa Gjykata ka filluar të zhvillojë SMIL, prandaj pritet të krijohet mundësi më të mëdha për monitorimin, referimin, veçimin dhe përcjelljen e trajtimit të lëndëve në mënyrë kronologjike. Megjithatë efektet e SMIL mbeten për t'u parë, pasi zbatimi ka filluar në dhjetor të vitit 2019.

**Konkluzion i përgjithshëm:** Kosova ka një bazë të fortë ligjore që është në përputhje me standardet evropiane për mbrojtjen e lirisë së shprehjes, lirinë e medias, të drejtën e informimit, dhe aspekteve që ndikojnë në sektorin e medieve. Për më tepër, të drejtat dhe liritë themelore të njeriut të njohura ndërkombëtarisht janë të garantuara me Kushtetutë. Një numër i gjetjeve të këtij hulumtimi tregojnë se shkalla e ulët e zbatimit dhe pamundësia e sigurimit të disa garancive të rëndësishme që jep legjislacioni e ka të penguar në masë të madhe zhvillimin e mëtutjeshëm të sektorit të medieve. Në të njëjtën kohë, përpjekjet, si ato për krijimin e sistemit të konsoliduar të mbledhjes së të dhënave për kërcënimet dhe për sulmet ndaj gazetarëve janë tregues të tendencës për t'i forcuar mekanizmat e llogaridhënies dhe transparencës brenda institucioneve dhe të vullnetit politik për t'i kushtuar më shumë rëndësi çështjes së sigurisë së gazetarëve. Mbrojtjes dhe sigurisë së gazetarëve i është shtuar një komponentë shtesë me rritjen e bashkëpunimit mes AGK-së dhe Prokurorisë, Gjykatës Themelore në Prishtinë dhe Policisë së Kosovës. AGK-ja është duke bashkëpunuar me të tria këto palë për të siguruar përcjelljen e lëndëve, përmirësimin e referimeve dhe ofrimin e ndihmës juridike për gazetarët.

Një gjetje tjetër e rëndësishme e këtij hulumtimi është lidhja e ngushtë midis kushteve të këqija të punës së gazetarëve ashtu sikurse presionit dhe ndikimit që ushtrohet ndaj gazetarëve, gjë që shpie në shkelje të Kodit të Etikës dhe Kodit të sjelljes së medieve dhe të gazetarëve dhe rrjedhimisht në cilësinë e raportimit të gazetarëve. Këto ndikime duket se vazhdojnë edhe më tutje, derisa organet rregullatore dhe vërtetuese nuk kanë resurse të mjaftueshme për monitorim më të plotë të sektorit të medias. Në përpjekjeve për të siguruar mbështetje për gazetarët, AGK-ja u ka bërë thirrje publike gazetarëve për rritjen e llogaridhënies për zbatimin e standardeve etike dhe profesionale gjatë raportimit të tyre.

## Rekomandimet

Legjislacioni lidhur me çështje të medias në përgjithësi - me hapësirë për përmirësim - konsiderohet si bazë solide për krijimin e kushteve dhe rrethanave për funksionimin dhe zhvillimin e sektorit të medias dhe për funksionimin e mekanizmave rregullues e vetrregullues të këtij sektori. Por, është e nevojshme të krijohen mekanizmat për zbatimin e plotë të këtij legjislacioni. Nga gjetjet e këtij hulumtimi dalin disa rekomandime:

**Sigurimi i qëndrueshmërisë financiare së Transmetuesit Publik** dhe ruajtja e pavarësisë editoriale, pengimi i ushtrimit të ndikimit politik dhe ruajtja e pavarësisë së vet në përputhje me statusin e vet.

- **Stabiliteti Financiar:** RTK-ja duhet të trajtohet si institucion publik dhe duhet të gjenden mënyrat e duhura të financimit. Një prej mënyrave të mundshme mund të jetë parapagimi i licencave përmes faturave të energjisë elektrike ose ndonjë skemë tjetër e financimit përmes taksave, abonimit dhe/ose burimeve të tjera të pavarura. Çdo mënyrë e financimit duhet të përcillet me procedurë të qarta që sigurojnë përgjegjshmërinë e palëve të përfshira dhe pavarësinë e transmetuesit publik, RTK-së. Vetëm një qëndrueshmëri financiare mund të shpie në rikthimin e besimit të publikut në Transmetuesin Publik.
- **Emërimi i Bordit të RTK-së:** Në RTK duhet të sigurohet paanshmëri politike. Duhet të gjendet një formë tjetër e përzgjedhjes së anëtarëve të bordit drejtues, pasi zgjedhja e tyre nga Kuvendi i Kosovës i bën ata të brishtë përballë presioneve politike që vijnë nga jashtë. Procesi i përzgjedhjes së anëtarëve të bordit duhet të jetë transparent dhe në të duhet të marrin pjesë autoritete të shquara të fushës, njerëz me integritet të lartë moral e profesional që mund t'i përballojnë presionet dhe ndikimet politike.

Në procesin për sigurimin e qëndrueshmërisë financiare dhe ngritjes së shkallës së përgjegjshmërisë së Transmetuesit Publik, AGK-ja është përfshirë në procesin e hartimit të Projektligjit për RTK-në, përmes rekomandimeve dhe formave të ndryshme të avokimit për sigurimin e pavarësisë editoriale të këtij transmetuesi.

**Forcimi i organeve rregullatore dhe vetërregullatore, KPM-së dhe KMSHK-së,** në mënyrë që të krijohen mundësi për ushtrimin e plotë të të gjitha obligimeve dhe përgjegjësisë të tyre ligjore dhe për krijimin e mekanizmave dhe formave për ngritjen e cilësisë së medie.

- **Emërimi i Bordit të KPM-së:** duhet të bëhet duke shmangur rreziqet nga ndikimet politike dhe duke adoptuar kritere të rrepta që pamundësojnë zgjedhjen e njerëzve të afërt me politikën për anëtarë të bordit. Kriteret e përzgjedhjes së anëtarëve të bordit të KPM-së duhet të jenë të njëjta me ato të përzgjedhjes së bordit drejtues të RTK-së dhe duhet të jetë plotësisht transparente për publikun.
- **Rritja e kompetencave të organeve vetërregulluese.** Një aspekt tjetër i rëndësishëm për rritjen e nivelit të transparencës dhe të përgjegjësisë së medie është sigurimi i elementeve që kanë të bëjnë me statusin, pronarët dhe pronësinë e tyre. Një tjetër aspekt është edhe monitorimi i medie online.
- **Organet vetërregulluese duhet të kenë mekanizmat përkatës dhe burimet e nevojshme** për të ushtruar mandatin dhe kompetencat e tyre dhe për të forcuar rolin e tyre në zhvillimin e skenës mediale. Është e nevojshme një analizë gjithëpërfshirëse në mënyrë që të identifikohen zbrazëtitë dhe mangësitë që pengojnë zhvillimin e medias dhe të sigurojnë resurset e nevojshme për rregullimin e skenës mediale dhe për mbikëqyrjen e zbatimit të normave etike të gazetarisë.

**Përmirësimi i bashkëpunimit të institucioneve dhe mbështetja e përparimit procesit të referimit** për të siguruar përgjigje me kohë dhe proporcionale ndaj kërçimeve dhe presioneve ndaj gazetarëve. AGK-ja ka nënshkruar një Memorandum Mirëkuptimi me Odën e Avokatëve të Kosovës dhe është në proces të nënshkrimit të memorandumeve të mirëkuptimit me Policinë e Kosovës dhe me Gjykatën Themelore në Prishtinë. Me këto memorandume synohet të forcohet procesi i referimit. Aplikimi i SMIL-it do të lehtësojë procesin e mbledhjes së të dhënave dhe do të mundësojë monitorimin e proceseve për çështjet që kanë të bëjnë me gazetarët. Përveç këtyre, AGK-ja, përmes marrëveshjes së bashkëpunimit me Odën e Avokatëve të Kosovës, ka siguruar përfaqësim ligjor dhe konsultime falas për gazetarët që janë anëtarë të këtij asociacioni, në rastet kur ata/ato janë palë në proceset gjyqësore që kanë të bëjnë me punën e tyre.

**Sigurimi i pavarësisë më të madhe editoriale nga presioni dhe ndikimi.** Mediet duhet të kenë rregulloret e punës, përmes të cilave zvogëlohen mundësitë e ndërhyrjes së subjekteve politike, të grupeve të interesit apo të personave me ndikim, qoftë në mënyrë të drejtpërdrejtë apo përmes pronarëve dhe menaxhmenteve të medie. Në rregulloret e punës duhet të definohen qartë obligimet, detyrat dhe përgjegjësitë e të gjithë punëtorëve të përfshirë në të gjitha fazat e prodhimit dhe transmetimit të përmbajtjeve.



**Rritja e pajtueshmërisë me standardet profesionale përmes miratimit të Kodit të Sjelljes.** Mediet duhet të inkurajohen të hartojnë kodet e tyre etike ose të miratojnë kodet e organeve vetërregulluese që garantojnë pavarësi të plotë editoriale. Njëkohësisht, duhet të inkurajohen të krijojnë mekanizmat e brendshëm që mbikëqyrin aplikimin e Kodit Etik. Mediet duhet të sigurojnë mbrojtje efikase ndaj gjykimeve subjektive dhe ndaj paragjyqimeve të gazetarëve. AGK-ja, së bashku me UN Women, ka filluar organizimin e trajnimeve të gazetarëve për trajtimin e temave që kanë të bëjnë me kategori të caktuara shoqërore.

**Duhet të sigurohen mekanizmat e nevojshëm për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit.** Duhet të rishikohet dispozita e Ligjit për Qasje në Dokumentet Publike, në mënyrë që të përcaktohet një afat për realizimin e kërkesave për qasje në dokumente publike dhe të hartohen udhëzime të qarta për zbatimin e plotë të ligjit.

**Përmirësimi i pozitës ekonomike të gazetarëve dhe forcimi i rolit të sindikatave.** Punësimi i gazetarëve duhet të bëhet në bazë të kriterëve të caktuar ndërsa shpërblimi i tyre duhet të bëhet në bazë të cilësisë së punës. Kushtet e punës dhe shkalla e përbushjes së obligimeve të punëdhënësit ose të pronarit mund të përmirësohen duke shtuar numrin e inspektimeve të institucioneve kompetente.

Duhet të përkrahen kërkesat e organizatave sindikale për përmirësimin e kushteve të punës, ndërsa gazetarët e medieve që nuk kanë organizime sindikale duhet të inkurajohen t'i themelojnë ato ose t'u bashkohen organizatave sindikale ekzistuese.

AGK është duke i mbështetur kërkesat e gazetarëve për përmirësimin e kushteve të punës, përmes avokimit dhe pjesëmarrjes në grupet punuese dhe në forumet ku diskutohet për legjislacionin që ka të bëjë me mediet, me punën e tyre ose me të drejtat dhe liritë e gazetarëve.

